



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 225 Akti

Nr. 223 Vendimi
Tiranë, më 20.12.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në datën 19.12.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Edmond Hyka**, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionerit Olsi Komici, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit/përfaqësuesit të tij ligjor dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, aktualisht me funksionin e prokurorit, pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, është subjekt rivlerësimi që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.

Në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendimin nr.1, datë 22.11.2018 vendosi të fillojë hetimin administrativ, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Edmond Hyka, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave¹ (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit

¹Me shkresën nr. *** prot, datë 30.4.2018, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

të Informacionit të Klasifikuar² (në vijim, DSIK) dhe grupi i punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë³. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 10.12.2019 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond Hyka; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit "Ç" të Aneksit të Kushtetutës, nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 10.12.2019, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail* në rrugë elektronike, në datën 18.12.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 19.12.2019, ora 9:30, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se kishte marrë dijëni, nuk u paraqit personalisht, por u përfaqësua nga avokat J.D., anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. licence ***, i pajisur me prokurën e posaçme nr. ***, datë 18.10.2019, hartuar nga noterja A.K.M., Tiranë. Përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi me shkrim pranë Komisionit.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit, avokat J.D., parashtrroi përpara trupit gjykues dy kërkesa verbale: kërkesa e parë ishte për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit kohë shtesë deri në përfundim të gjendjes së jashtëzakonshme (periudha e tërmetit të nëntorit të vitit 2019) me qëllim që të riballafaqojë edhe një herë faktet dhe provat; kërkesa e dytë ishte për riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e një ekspertimi krahasues me analizat financiare, konkretisht atë që është pjesë e rezultateve të hetimit dhe atë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës.

Trupi gjykues, pasi u njoh me dy kërkesat e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit, u tërhoq për shqyrtimin e tyre dhe me vendim të ndërmjetëm vendosi të mos i pranojë kërkesat e bëra nga përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

Së pari: në lidhje me kërkesën e parë për kohë shtesë, trupi gjykues arsyeton se kërkesat që i janë drejtuar subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni janë kërkesa

²Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 (i deklasifikuar plotësisht me raportin nr. *** prot, datë 2.11.2017).

³Me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2019, dërgohet raporti i grupit të punës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

të përsëritura, që i janë bërë edhe më përpara subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Në lidhje me këto kërkesa, sikundër referoi edhe mbrojtësi ligjor, subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka kërkuar kohë shtesë për plotësimin e dokumentacionit dhe shpjegimeve për to. Subjektit i është dhënë nga Komisioni afati kohor shtesë 5- ditor dhe në vijim, pas përfundimit të këtij afati shtesë, nga subjekti nuk është kërkuar afat tjetër kohor shtesë për plotësimin e provave dhe shpjegimeve të tij. Gjithashtu, nga subjekti nuk rezulton të jetë kërkuar afat i ri për zgjatje të hetimit administrativ përpara seancës dëgjimore dhe nga përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit nuk u parashtrua asnjë kërkim apo provë konkrete, e cila të ketë qenë e pamundur për t'u marrë te palët e treta për arsye të gjendjes së emergjencës, për të cilën do të legjitimohej dhënia e një kohe shtesë nga trupi gjykues.

Së dyti: në lidhje me kërkesën për riçelje të hetimit, trupi gjykues, gjithashtu, vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë, pasi, për sa u referua nga mbrojtësi ligjor në lidhje me kryerjen e një ekspertimi krahasues për dy analizat financiare, njëra e kryer nga Komisioni dhe tjetra e paraqitur në barrë prove me dokumentacionin e sjellë nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni e konsideron të panevojshme kryerjen e këtyre analizave financiare, për sa kohë që ato do të analizohen dhe do të arsyetohen para vendimmarrjes përfundimtare dhe do të pasqyrohen në vendim nga trupi gjykues.

Në përfundim, përfaqësuesi ligjor i subjektit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond Hyka, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit u krye për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Komisioni, referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Me shkresën nr. *** prot., datë 30.4.2018, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka, i cili është subjekt deklarues që prej vitit 2005, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Në raport, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me deklaratimet e tij;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2005 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 27.1.2017.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1⁵, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Pas marrjes së raportit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti.

Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”, të depozituar nga subjekti në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

- 1. Apartament me sip. 121 m², përfituar sipas kontratës së shitblerjes datë 22.2.2005, me nr. ***, regjistruar në hipotekë në datën 7.6.2005 me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me vlerë 2,000,000 lekë dhe me pjesë takuese të papërcaktuar.**

Burimi i krijimit: të ardhurat si avokat dhe kursimet familjare.

Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, Drejtoria Vendore Durrës⁶, rezulton që pasuria e llojit “apartament”, me sip.121 m², nr. pasurie ***, z. k ***, vol. ***, f. ***, me adresë: Rr. “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Durrës, të jetë regjistruar në emër të z. Edmond Hyka.

⁵ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

⁶ OSHEE-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2019; UKT-ja me shkresën nr. *** prot, datë 27.9.2019; ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës me shkresën nr. *** prot, datë 4.12.2019.

Ky apartament është përfituar nga kontrata e shitjes datë 22.2.2005⁷ me shitës I.Ç. dhe blerës Edmond Hyka me sip. 121 m², për çmimin 2,000,000 lekë likuiduar jashtë zyrës noteriale. Për këtë pasuri është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie datë 7.6.2005.

Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës datë 5.5.2005, subjekti ka deklaruar: *“Një apartament, banesë tre dhoma e një kuzhinë me sip. 120 m². Vlera 2,000,000 lekë, me pjesë takuese 100 %, burim krijimi nga të ardhurat si avokat 1998-2005, si dhe me të ardhura të babait tim nga disa prona dhe vit i krijimit të pasurisë viti 2002”*.

Komisioni ka analizuar çmimin e pasqyruar në kontratën e shitblerjes së datës 22.2.2005 në shumën prej 2,000,000 lekësh, duke e krahasuar me çmimet referuese të përcaktuara në udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja dhe të koeficientit “K” për vitin 2005”.

EKB-ja ka përcaktuar se nga të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin Durrës, çmimi i apartamenteve përlllogaritet me 54,383 lekë/m² dhe për apartamentin konkret është 121 m² x 54,383 lekë/m² = 6,580,343 lekë.

Ka rezultuar se apartamentin e mësipërm subjekti e ka blerë në vlerën 4,580,343 lekë më lirë se vlera e tregut të përcaktuar në udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të EKB-së.

Komisioni ka konstatuar pasaktësi në lidhje me deklarinimin e vitit të krijimit të kësaj pasurie, pasi, subjekti në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës viti 2005, deklaroi si vit krijimi të pasurisë vitin 2002, ndërsa në deklaratën “Vetting” deklaroi se pasuria apartament me sip. 121 m² është përfituar me kontratën e shitblerjes së vitit 2005, por pa deklaruar vitin e krijimit të saj.

Në lidhje me këto pasaktësi subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar se: *“...në deklarinimin e pasurisë në momentin e emërimit në detyrë, për vitin 2005, kam sqaruar se në vitin 2002 kam blerë apartamentin nga z. I.Ç., apartamenti në atë kohë nuk kishte përfunduar plotësisht dhe se nuk ishin bërë dokumentet hipotekore. Në vitin 2005 pasi nga z. I.Ç. u mor dokumenti hipotekor, është hartuar dhe kontrata e shitjes me nr. ***, datë 27.4.2005 (shih bashkëngjitur kopja e kontratës) dhe unë e kam pasqyruar në deklarinim.”*

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me shitësit e apartamentit I. dhe V.Ç., se në çfarë rrethanash është njohur dhe nëse ka miqësi me ta.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Unë gjatë kohës që kam punuar si avokat kam njohur shtetasin I.Ç., ndërsa shtetasen V.Ç. nuk e njoh. Marrëdhëniet me të kanë qenë jo të afërta, por unë kam pranuar riskun kur kam blerë apartamentin dhe marrëdhëniet janë ndërprerë me kohë.”*

Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit me shtetasin I. dhe V.Ç., duke kryer korrespondencë me Prokurorinë e Apelit Durrës dhe Tiranë⁸.

Prokuroria e Apelit Durrës ka konfirmuar se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë çështje penale në ngarkim të shtetasve I. dhe V.Ç.

Prokuroria e Apelit Tiranë ka konfirmuar se pranë saj janë trajtuar disa çështje penale, ku palë në gjykim ka qenë shtetasi I.Nj.Ç., kërkues, me objekt gjykimi: kundërshtim vendim pushimi të

⁷ Kontrata e shitjes nr. ***, datë 22.2.2005.

⁸ Shkresë nr. *** prot, datë 2.12.2019, Prokuroria e Apelit Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, Prokurori e Apelit Tiranë.

procedimit penal nr. *** të vitit 2011 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokuror Edmond Hyka me datë 20.3.2018, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 2,000,000 lekë

Subjekti ka deklaruar se kjo shumë është krijuar nga puna si avokat dhe nga kursimet familjare.

Subjekti nuk ka specifikuar se sa nga shuma prej 2,000,000 lekësh janë të ardhura nga puna si avokat dhe sa të ardhura janë nga kursimet e familjes.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 2,000,000 lekësh duke specifikuar sa nga kjo shumë janë të ardhura nga avokatia dhe sa janë të ardhura nga kursimet e familjes, si dhe të vërtetojë burimin e ligjshëm të tyre me dokumentacion ligjor mbështetës.

Subjekti në përgjigje të tij ka shpjeguar se: *“Shuma e investuar në blerjen e apartamentit është kryesisht nga kursimet e aktivitetit si avokat. Me kursimet familjare është nënkuptuar përdorimi me kujdes dhe ekonomi i të ardhurave totale.*

*Kursimet e familjes janë nga: rroga e bashkëshortes dhe e imja ndër vite, nga të ardhurat e mia si avokat, ku kam qenë i regjistruar pranë Degës së Tatimeve Durrës me NIPT ***. Deklarimi i të ardhurave nuk ka qenë detyrim ligjor...*

*Në bazë të ligjit të kontabilitetit detyrimi ligjor për ruajtjen e dokumenteve financiare është deri në 10 vjet. Meqenëse nga vitit 2005, vit i fillimit të detyrës deri në vitin 2015 nuk më janë nxjerrë probleme në deklarim këtë dokumentacion nuk e disponoj më, pasi kishte kaluar detyrimi ligjor për ruajtjen e tyre dhe e kam konsideruar të pavlefshëm ruajtjen e mëtejshme të tyre. Si dokument justifikues paraqes vendimin gjyqësor nr. ***, datë 28.12.2005 “Për çregjistrimin e personit fizik”, kopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor për vitin 2004 me nr. serial ***.*

*Në vitin 2002 kam marrë shpërblimin për largim të padrejtë nga detyra sipas vendimit Nr. ***, datë 14.12.2001, të Gjykatës në vlerën neto 418,440 lekë (bashkangjitur praktika e shpërblimit).*

*Për të ardhurat nga paga të krijuara nga bashkëshortja është dorëzuar dokumentacioni i vërtetimit të pagës në vite, në momentin e deklaratës Vetting, sipas shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2016, të Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Durrës”.*

2. Dyqan me sip. 52.50 m², me adresë: *, stacioni i ***, Lokali ***, me nr. pasurie ***, përfitur nga kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 8.5.2005, me vlerë 500,000 lekë, me pjesë takuese të papërcaktuar.**

Burimi i krijimit: të ardhurat e subjektit dhe të ardhurat familjare

Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në Drejtoria Vendore Durrës⁹, rezulton se pasuria e llojit “****” me sip. 52.5 m² në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me adresë: ***, Durrës, është regjistruar në emër të z. Edmond Hyka. Nga kartela e pasurisë rezulton se kjo njësi fillimisht ka qenë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe më pas ka kaluar në emër të z. Edmond Hyka.

Kjo pasuri është përfitur me kontratën e shitblerjes së datës 8.3.2005¹⁰ me palë shitëse shtetasit L.D., I.A. dhe S.B. të cilët janë bashkëpronarë me 1/3 pjesë secili të njësisë (***), lokali ***, shk. ***, dhe blerës Edmond Hyka, për çmimin 500,000 lekë, pagesë e bërë *cash*.

⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2019, ASHK, Drejtoria Vendore Durrës.

¹⁰ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 8.3.2005.

Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, datë 5.5.2005, subjekti deklaron: “Një bodrum, dyqan kati nëntokësor me sip. 52 m², me vlerë 5,000,000 lekë (e shprehur dhe me fjalë pesë milionë lekë), pjesë takuese 100 %, burim krijimi nga të ardhurat si avokat në vitet 1998-2005, si dhe me të ardhura të babait tim nga disa prona dhe vit i krijimit 2002”.

Referuar çmimit prej 500,000 lekësh, të pasqyruar në kontratë për blerjen e kësaj pasurie me sip. 52.50 m² përlogarit se çmimi i blerjes për m² për këtë njësi është 9524 lekë/m², çmim ky që duket mjaft i ulët po të krahasohet me çmimin referues të blerjes së apartamenteve në vitin 2005, referuar nga EKB-ja, që për qytetin e Durrësit përlogarit 54,383 lekë/m².

Komisioni ka konstatuar pasaktësi në lidhje me deklarin e vitit të krijimit të kësaj pasurie, pasi subjekti në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2004 deklaron si vit krijimi të pasurisë vitin 2002, ndërsa në deklaratën “Vetting” deklaron se pasuria dyqan me sip. 52.5 m² është përfituar me kontratën e shitblerjes së vitit 2005.

Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar pasaktësi në deklarin e çmimit të dyqanit. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2005 subjekti deklaron vlerën 5,000,000 lekë (të shprehura dhe me fjalë pesë milionë), ndërsa në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron vlerën 500,000 lekë. Kontrata e shitblerjes pasqyron çmimin 500,000 lekë.

Për të sqaruar këto pasaktësi Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili ka shpjeguar se: “Unë vlerën e dyqanit e kam paguar më përpara. Në vitin 2003 për dyqanin është perkujdesur babai im, pa ndonjë akt juridik të shkruar, ndërsa kontratën e kam bërë më pas, për shkak se në vitin 2005 u mor nga firma ndërtuese dokumenti hipotekor dhe nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes në mars të vitit 2005.

Kontrata e shitjes është bërë pasi nga firma ndërtuese është hipotekuar objekti i ndërtimit dhe janë lidhur dhe kontratat përkatëse, ndonëse vlerën e tij e kisha paguar më parë, duke marrë parasysh edhe riskun.

Ju theksoj se vlera e blerjes se dyqanit është ajo e kontratës, pasi në përpilimin e deklaratës në vitin 2005, është bërë lapsus duke u shkruar me gjuhën e lekëve të vjetra. Pasi edhe sot në rast se do të shitej dyqani vlera e tregut është shumë herë më e vogël se shuma e 5.000.000 lekëve (të reja)”.

Komisioni ka hetuar dhe mbi ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shitësit e dyqanit L.D., I.A. dhe S.B. Për këtë qëllim Komisioni ka kryer korrespondencë me Prokurorinë e Apelit Durrës¹¹ dhe Prokurorinë e Apelit Tiranë.

Nga korrespondenca e kryer nuk ka rezultuar ndonjë situatë konflikti interesi e subjektit të rivlerësimit me këta persona.

Analizë financiare për blerjen e apartamentit dhe të dyqanit në vitin 2002 me të ardhurat nga avokatia dhe me kursimet familjare

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e këtyre pasurive të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1998 - 2005 dhe kursimet familjare.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës¹², në përgjigje të kërkesës së Komisionit në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat të subjektit, me NIPT ***, ka konfirmuar se subjekti tregtar ka ushtruar aktivitet për periudhën 2000 - 2005 dhe ka krijuar qarkullim faktik në shumën 4,182,500 lekë. Për vitin 2003 nuk ka informacion nga institucioni tatimor për qarkullimin faktik.

¹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 2.12.2019, Prokuroria e Apelit Durrës; shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2019, Prokurori e Apelit Tiranë.

¹² Shkresa nr. *** prot., datë 10.10.2019, Drejtoria Tatimore Durrës.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me periudhën e ushtrimit të profesionit, e cila sipas deklaramit të tij është kryer në vitet 1998 - 2005, ndërsa sipas konfirmimit nga QKB dhe DRT është kryer në vitet 2000 - 2005.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “*Kam aplikuar për hapjen e aktivitetit si avokat e kam hapur në nëntor të vitit 1999. Për shkak se ishte fundi i vitit dhe për periudhën nëntor-dhjetor nuk kam pasur aktivitet, licenca është bërë aktive pranë Degës së Tatim Taksave Durrës në vitin 2000. Në atë kohë legjislacioni tatimor kërkonte që për çdo vit të hapej aktiviteti me një vendim gjykate. Për këtë arsye duke qenë se në vitin 1999 nuk e ushtrova aktivitet e kam rinovuar licencën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.*

Për shkak të përgjegjësisë tatimore si biznes i vogël, subjekti tregtar nuk ka pasur detyrim për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe fitimit të realizuar. Komisioni, për llogaritjen e fitimit është bazuar në qarkullimin faktik dhe normën e fitimit për këtë lloj aktiviteti, e cila është në masën 80%.

Të ardhurat nga aktiviteti si avokat për periudhën 2000 - 2002, që kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurive, paraqiten si më poshtë:

Viti	Qarkullimi i parashikuar	Qarkullimi faktik	Fitimi i realizuar
2000	800,000	1,100,000	880,000
2001	1,100,000	1,420,000	1,136,000
2002	1,300,000	687,500	550,000
Total	3,200,000	3,207,500	2,566,000

Në lidhje me kursimet familjare, Komisioni ka marrë në analizë të gjitha burimet e tjera të të ardhurave të deklaruara nga subjekti deri në momentin e krijimit të pasurisë, pasi janë zbritur shpenzimet jetike.

Në përfundim, Komisioni ka analizuar aftësinë paguese në momentin e blerjes së pasurisë, nga e cila sipas tabelës së mëposhtme rezulton se subjekti ka pasur mundësi të blejë apartamentin në qytetin e Durrësit.

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	5,537,419
1	Të ardhura nga pagat Edmond Hyka, vitet 1992 - 1999 ¹³	1,685,479
2	Të ardhura nga aktiviteti si avokat, vitet 2000 - 2002	2,566,000
3	Të ardhura nga pagat bashkëshortja, datë 31.12.2002	867,500
4	Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, viti 2002 ¹⁴	418,440
B	Pasuri	2,500,000
1	Blerë apartament në Durrës 121 m ² në datën 2002	2,000,000
2	Blerë dyqan në vitin 2002	500,000
C	Shpenzime	2,492,111
1	Shpenzime jetike 1.1.1992 - 31.12.2002	2,492,111
	Mundësia financiare në momentin e blerjes së ap. dhe dyqanit (A-B-C)	545,308

¹³ Vërtetim datë 26.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës.

¹⁴ Kartela shoqëruese e praktikës me nr. *** prot., datë 25.6.2002, dërguar degës së financës për përmbushjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Shpenzimet jetike, vitet 1992 - 1996 (70%)	645,743
Totali i të ardhurave, vitet 1992 - 1996	922,490
Të ardhurat nga paga Edmond Hyka, vitet 1992 - 1996	784,170
Të ardhurat nga paga E.H., vitet 1992 - 1996	138,320
Shpenzimet jetike, vitet 1997 - 1999	720,000
5,000 lekë/muaj për person	720,000
Shpenzimet jetike, vitet 2000 - 2002	1,126,368
sipas informacionit të INSTAT-it	1,126,368
Total shpenzime jetike, vitet 1992 - 2002	2,492,111

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit që të japë shpjegime më të qarta në lidhje me apartamentin me sip. 121m² në qytetin e Durrësit, për sa i përket mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues për blerjen e shtëpisë në vitin 2002, çmimit të blerjes, i cili është shumë më i ulët se çmimi referues i përcaktuar në udhëzimin e EKB-së, si dhe mospërputhjes në deklaram të burimit të krijimit të shumës 2,000,000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni ka shpjeguar se apartamentin e ka blerë në vitin 2002, i papërfunduar plotësisht dhe nuk ishin bërë dokumentet hipotekore, por në vitin 2005 pas marrjes së dokumentacionit nga shitësi I.Ç., po atë vit u hartua edhe kontrata e shitjes së datës 27.4.2005.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues ligjor që apartamenti është blerë në vitin 2002 ashtu siç edhe e ka deklaruar.

Referuar çmimit të blerjes, subjekti ka deklaruar se: *“... ai është çmimi real dhe në kohën e blerjes së apartamentit në asnjë zyrë noteriale nuk referohej çmim reference dhe në një shoqëri të tregut të lirë e rëndësishme është marrëveshja e palëve”*.

Gjithashtu, në lidhje me çmimin prej 2,000,000 lekësh të blerjes së apartamentit që në dukje është çmim preferencial, subjekti ka shpjeguar se: *“... në kohën e blerjes së apartamentit nuk ka pasur asnjë funksion shtetëror por ka punuar si mbrojtës ligjor (avokat) dhe pikërisht nga të ardhurat e kësaj pune dhe kursimet e familjes u krijua dhe shuma dhe për rrjedhojë çmimi nuk është preferencial”*

Për sa i përket mospërputhjes në deklaram të burimit të krijimit, të gjitha të ardhurat nga kursimet e prindërve dhe nga aktiviteti i tij, si dhe nga shitja e pronave të prindërve subjekti ka shpjeguar se: *“...janë administruar nga babai dhe është e pamundur të përcaktohet saktësisht ky burim krijimi i të ardhurave të sipërpërmendura”*.

Gjithashtu, edhe përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore ka kundërshtuar referencën e EKB-së të përdorur nga Komisioni, me pretendimin se çmimet nuk kanë qenë detyruese në atë periudhë, praktikisht gjithçka që vendoste ishte tregu dhe çmimet detyruese janë vendosur rreth vitit 2008.

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit që të japë shpjegime më të qarta në lidhje me dyqanin me sip. 52.50 m² në Plazh, Durrës, në lidhje me mungesën e dokumentacionit ligjor për të provuar pagimin e çmimit të blerjes përpara vitit 2005, në lidhje me çmimin e blerjes prej 500,000 lekësh, që duket shumë më i ulët se çmimi i përcaktuar nga EKB-ja, qoftë edhe po të krahasohet me çmimin e blerjes së apartamenteve për vitin 2005, si dhe në lidhje me mospërputhjen në deklaram të burimit të krijimit.

Subjekti në përgjigjet e tij ka shpjeguar se çmimi i blerjes prej 500,000 lekësh është çmim i paguar përpara se të përfundonte ndërtimi i plotë i tij dhe se në kohën e nënshkrimit të kontratës në asnjë zyrë noteriale nuk referohej çmim reference, por pasqyrohej marrëveshja midis palëve kontraktuese. Kontrata e shitjes e vitit 2005 është bërë pasi nga firma u mor dokumenti hipotekor dhe më pas u lidh kontrata përfundimtare në vitin 2005. Llogaritja prej Komisionit me dyfishin e çmimit të shitjes së apartamenteve është jo ligjore dhe e gabuar, kjo pasi lokalet bodrum kishin çmim më të ulët, sa gjysma e çmimit të apartamenteve. Në kohën e blerjes së këtij lokali subjekti deklaroi se nuk ka pasur asnjë funksion shtetëror, por ka punuar si avokat.

Në lidhje me mospërputhjen në deklaram për sa i përket burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar se të gjitha të ardhurat (përfshirë dhe ato të subjektit) janë administruar nga babai i tij dhe për rrjedhojë e ka të pamundur të përcaktohet saktësisht burimi i krijimit të të ardhurave dhe kursimeve nga prindërit, nga aktiviteti i subjektit apo edhe nga shitja e pronave të prindërve.

Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave nga avokatia subjekti ka deklaruar se diferenca në deklaram nga 10,000,000 lekë në 8,875,500 lekë vjen si rrjedhojë e mungesës së njohurive financiare dhe kontabël. Subjekti ka bashkangjitur dhe një akt ekspertimi financiar nga një auditues ligjor privat.

Përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore ka theksuar se nga Komisioni nuk është marrë parasysh fakti që dyqani është bodrum dhe se vlera është gjysma e një apartamenti të zakonshëm dhe nuk është si gjithë dyqanet e tjera.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Durrës, dokumentacionin e depozituar nga subjekti, si dhe deklaramet e subjektit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, arrin në konkluzionin se:

- subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për sa i përket vitit të përfitimit të apartamentit dhe të dyqanit;
- çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti i pasqyruar në kontratën e shitblerjes datë 22.2.2005, prej 2,000,000 lekësh (16,528 lekë/m²) nuk krijon bindjen se është çmimi real i blerjes, pasi rezulton të jetë disa herë më i ulët krahasuar me çmimet referuese të EKB-së, si për vitin 2005 ku çmimi referues në tregun e lirë të apartamenteve është 54,383 lekë/m², ashtu edhe për vitin 2002 ku përcaktohet çmimi referues 65,361 lekë/m².

Edhe po t'i referohemi koston mesatare të ndërtimit për vitin 2002 për qytetin e Durrësit, rezulton të jetë në vlerën 26,046 lekë/m² që përsëri rezulton të jetë dukshëm më e madhe se çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti për vlerën 16,528lekë/m².

- Çmimi i blerjes në vlerën 500,000 lekë, të dyqanit me sip. 52 m² (9,615 lekë/m²), nga subjekti, me kontratën e shitblerjes datë 8.5.2005, nuk krijon bindjen se është çmimi real i blerjes pasi rezulton të jetë shumë herë më i ulët krahasuar me çmimet referuese të EKB-së, si për vitin 2005 ku çmimi referues në tregun e lirë të apartamenteve është 54,383 lekë/m², ashtu edhe për vitin 2002 ku përcaktohet çmimi referues për 65,361 lekë/m². Edhe nëse marrim në konsideratë

pretendimin e përfaqësuesit ligjor të subjektit se dyqani është bodrum dhe se vlera është gjysma e një apartamenti të zakonshëm, përsëri çmimi i blerjes së dyqanit është shumë më i ulët sesa gjysma e vlerës së një apartamenti, që për rastin konkret rezulton të jetë 1,000,000 lekë.

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit dhe dyqanit.
- 3. Banesë private me sip. truall 308.5 m² në pronësi të z. Edmond Hyka regjistruar në hipotekë në datën 13.7.2010, me vlerë që nuk është përcaktuar, si dhe me pjesë takuese të përcaktuar.**

Burimi i krijimit: trashëgimi nga babai, nëna dhe motrat e subjektit (kontratë dhurimi).

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës¹⁵ ka konfirmuar se në emër të z. Edmond Hyka rezulton e regjistruar pasuria truall me sip. 308.5 m² dhe ndërtesë me sip. 87.5 m², e ndodhur në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** me adresë: Rr. "****", vol. ***, f. ***, Durrës.

Kjo pasuri, fillimisht ka qenë në emër të shtetasit I.H. Pas vdekjes së tij, me dëshmi trashëgimie ka kaluar në emër të shtetasve Xh., E., T. dhe D.Ç. dhe në fund me kontratë dhurimi ka kaluar në pronësi dhe është regjistruar në emër të shtetasit Edmond Hyka.

Kjo pasuri është përfituar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 24.1.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që njeh si pronar shtetasin I.H. mbi një shtëpi banimi të ndërtuar në vitet 1960, me sip. ndërtimi 87.5 m² në katin e parë dhe kati i dytë me sip. 80m² i papërfunduar, si dhe pronësinë mbi një sip. truall 308.5 m², me adresë: Rr. "****", banesa nr. ***, Durrës.

Subjekti, në deklaratën e pasurisë të vitit 2010, ka deklaruar mënyrën e fitimit të pronësisë si trashëgimi nga i ati dhe më pas me dhurimin nga motrat të pjesës së tyre takuese.

Në deklaratat periodike të pasurisë nga viti 2011 deri në vitin 2016 subjekti ka deklaruar: *"Jam në pritje të lejes së legalizimit dhe ndryshimet do t'i pasqyroj kur të legalizohet investimi."*

Pasi ka ndërruar jetë z. I.H. në vitin 2009, me vendimin nr. ***, datë 9.6.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin I.H., ndërruar jetë më 12.2.2009, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë: 1. Xh.H. (bashkëshortja); 2. E.H. (i biri); 3. T.M. (H.) e bija; 4. D.Ç. (H.), të cilët trashëgojnë nga ¼ pjesë.

Me deklaratën noteriale të datës 12.3.2010,¹⁶ deklaruesit Xh.H., T.M. dhe D.Ç. deklarojnë se: *"...deklarojmë në përgjegjësinë tonë se I.H. para vdekjes dispononte pasuritë dhe vlerat monetare të mëposhtme:*

- *shuma 35,000 euro nga të cilat 10,000 euro kanë qenë të depozituara në "Intesa Sanpaolo Bank" dhe 25,000 euro gjendje në shtëpi;*
- *shuma 5,000,000 lekë e depozituar në banka të ndryshme;*
- *banesë me vendndodhje në Durrës, L. ***, Rr. "****" e cila është në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së Durrës.*

Ne deklarueset, duke respektuar vullnetin e I.H. para vdekjes, deklarojmë se vlerat monetare dhe shtëpinë e banimin do t'ia kalojmë në favor të Edmond Hyka dhe ne nuk kemi asnjë pretendim për të drejta pronësie mbi këto pasuri".

Me kontratën e dhurimit të datës 7.7.2010¹⁷, pala dhuruese Xh.H., T.M. dhe D.Ç. i kanë dhuruar z. Edmond Hyka, i cili nga ana e tij e ka pranuar dhurimin, pjesën e tyre takuese në pasurinë e

¹⁵ ASHK, Drejtoria Vendore Durrës me nr. *** prot., datë 4.12.2019.

¹⁶ Deklarata noteriale nr. ***, datë 12.3.2010.

¹⁷ Kontrata e dhurimit nr. ***, datë 7.7.2010.

paluajtshme truall me sip. 308.5 m², ndodhur në L. ***, Rr. “***”, nga ku 308.5 m² truall dhe 87.5 m² ndërtesë, z. k. ***, Durrës, dhurim i cili bëhet pa kushte dhe me vullnet të lirë.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2010 subjekti ka deklaruar se : “...kam lidhur kontratën e datës 14.11.2010 për investim dhe sipërmarrje me shoqërinë “***” sh.p.k., Durrës. Për shkak të mosmarrjes ende të lejes së ndërtimit, nuk kemi rënë dakord për ndarjen e investimit. Kur të përfitoj pasurinë sipas kontratës do të plotësoj dhe deklaramin përkatës.”

Subjekti ka depozituar kontratë investimi dhe sipërmarrje në ndërtim lidhur në datën 14.11.2010¹⁸ me palë investitore dhe ndërtuese shoqërinë “***” sh.p.k., dhe pronar të truallit z. Edmond Hyka me objekt: dhënie prej pronarit të truallit për sipërmarrje ndërtimore të pasurisë, tokë truall me sip. 308.5 m² nga të cilat 87.5 m² ndërtesë, me vendndodhje L. ***, Rr. “***”, Durrës. Pala investitore do të ndërtojë një godinë banimi dhe shërbimi jo më pak se tetë kate. Nga ky investim, 37 % të sipërfaqes ndërtimore do ta përfitojë pronari i tokës, kurse investitori do të përfitojë 63 % të sipërfaqes ndërtimore.

Komisioni ka konstatuar se në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e investimit të lidhur në datën 14.11.2020, me shoqërinë “***” sh.p.k., si dhe gjendjen juridike në të cilën ndodhet aktualisht prona dhe për këtë qëllim i është kërkuar subjektit të japë shpjegime.

Subjekti, në përgjigjen e tij ka sqaruar se: “Në deklaratën Veting, nuk është pasqyruar kjo kontratë për shkak se firma investitore nuk arriti të marrë lejen e ndërtimit deri në fund të vitit 2016 dhe kontrata mbetej e pa përfunduar. Nuk është bërë asnjë investim për shkak se nuk u dha leja e ndërtimit. Kjo banesë i është dhënë me qira në vitin 2019 shtetases M.L. si përfaqësuese e shoqatës Qendra “***” me kontratën e qirasë nr. ***, datë 6.2.2019”.

Komisioni ka hetuar dhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “***” sh.p.k., dhe administratorin e saj z. A.B., duke kryer korrespondencë me Prokurorinë e Apelit Durrës¹⁹ dhe me Prokurorinë e Apelit Tiranë.

Nga përgjigjet e këtyre dy institucioneve nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të depozitonte dokumentacion ligjor për të provuar gjendjen faktike të kësaj pasurie në bazë të cilit është aplikuar për legalizim, si dhe të japë shpjegime në lidhje me kontratën e investimit të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k.

Subjekti në përgjigjet e tij ka shpjeguar se në lidhje me këtë pasuri ka lidhur një kontratë investimi dhe sipërmarrjeje në datën 14.11.2010 me shoqërinë “***” sh.p.k., e cila nuk arriti të merrte lejen e ndërtimit dhe për këtë shkak me mbarimin e afatit të kontratës, në deklaratën “Vetting” kjo kontratë nuk u deklarua pasi nuk kishte sjellë asnjë pasojë juridike. Banesa në fjalë i është dhënë me qira shtetases M.L. si përfaqësuese e shoqatës “***” me kontratën e qirasë së datës 6.2.2019.

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka depozituar kontratën e qirasë së datës 6.2.2019²⁰, fotografi të gjendjes faktike të truallit me sip. 308.5 m², si dhe të shtëpisë në Durrës me sipërfaqe 87.5 m².

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

¹⁸ Kontrata e investimit nr. ***, datë 14.11.2010.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot, datë 2.12.2019, Prokuroria e Apelit Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, Prokuroria e Apelit Tiranë.

²⁰ Kontrata e qirasë nr. ***, datë 6.2.2019.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Durrës, dokumentacionin e depozituar nga subjekti, si dhe deklaratimet e tij, arriti në konkluzionin se përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e depozituar dhe me gjendjen faktike të objektit të pasqyruar në fotot e depozituara nga subjekti, duke mos konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.

4. Të ardhura nga qiraja e dyqanit në qytetin e Durrësit për periudhën 29.3.2007 – 28.3.2013 – 2.1.2016, në shumën 2,100,000 lekë

Subjekti ka depozituar:

- kontratën e qirasë së datës 29.3.2007²¹, me qiradhënës subjektin Edmond Hyka dhe qiramarrës D.K., me objekt: dhënie me qira e apartamentit me sip. 52.5 m², në adresën: L. ***, Durrës, me qira vjetore fikse 200,000 lekë/vit, për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 2.4.2007 – 2.4.2012. Në kontratën e qirasë parashikohet se tatimi mbi çmimin e qirasë do të likuidohet nga pala qiramarrëse;
- kontratën e qirasë së datës 28.3.2013²², me qiradhënës/posedues Edmond Hyka dhe qiramarrës D.K., me objekt: dhënie me qira të apartamentit me sip. 52.5 m² në adresën: L. ***, Durrës, me qira vjetore fikse 200,000 lekë/vit, për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 2.4.2013 – 2.4.2018. Në kontratën e qirasë parashikohet se tatimi mbi çmimin e qirasë do të likuidohet nga pala qiramarrëse.

Në deklaratën periodike të pasurisë të viteve 2007, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 subjekti deklaroi: “Të ardhura nga qiraja e dyqanit në vlerën 200,000 lekë”.

Në deklaratën periodike të pasurisë të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016 subjekti deklaroi: “Të ardhura nga qiraja e lokalit në vlerën 240,000 lekë”.

Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka depozituar kontratën e qirasë për periudhën 2.4.2012 – 28.3.2013 dhe për këtë arsye i ka kërkuar shpjegime subjektit.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “*Dyqani është dhënë me qira të njëjtit person, z. D.S.K., dhe periudha në fjalë ka mbetur e pambuluar, duke u neglizhuar konfirmimi me shkrim i vazhdimit të kontratës (nuk e konfirmova në kohë mbarimin e saj), por kontrata e qirasë ka vazhduar me mirëkuptim në heshtje. Bashkëngjitur deklaratat noteriale e palës qiramarrëse, z. D.S.K.*”

Subjekti ka depozituar si dokument provues deklaratë dore të datës 3.12.2019²³, me deklarues D.K. dhe Edmond Hyka, të cilët deklarojnë se për arsye neglizhence ka mbetur pa mbuluar me kontratë periudha e qiradhënies 2.4.2012 – 28.3.2013.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, me kalimin e barrës së provës, i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion ligjor pagimin e tatimit në burim për të ardhurat nga qiraja e përfutur për periudhën 29.3.2007 – 28.3.2013 – 2.1.2016, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke evidentuar gjithashtu edhe faktin se ka mungesë dokumenti ligjor provues për marrëdhënien e qirasë për periudhën 2.4.2012 – 28.3.2013.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “*...në kontratën e qirasë është përcaktuar se qiramarrësi do të përdorë ambientin tregtar dhe do të paguajë tatimin në burim që*

²¹ Kontrata e qirasë nr. ***, datë 29.3.2007, me qiradhënës G.H. dhe D.K.

²² Kontrata e qirasë nr. ***, datë 29.3.2007, me qiradhënës G.H. dhe D.K.

²³ Deklarata dore, por me vërtetim nënshkrimi te noteri.

rrjedh nga të ardhurat e qirasë. Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat', i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, 'Për procedurat tatimore', i ndryshuar, detyrimin për mbajtjen në burim dhe pagimin e tatimit e ka subjekti tatimor qiramarrës. Nuk është përgjegjësia ime për pagimin e këtij tatimi, por e organeve tatimore dhe subjektit tatimor.”

Ndërsa në lidhje me periudhën e pambuluar me kontratë qiraje, subjekti ka deklaruar se: “...deklarata noteriale datë 3.12.2019, e qiramarrësit D.S.K. konfirmon që edhe periudha e pambuluar 2.4.2012 – 28.3.2013 ka qenë në fuqi me kushtet e kontratës së mëparshme. Kjo periudhë ka mbetur e pambuluar me kontratë për shkak se kontrata e mëparshme ishte me afat 5-vjeçar dhe afati i përfundimit të qirasë ishte harruar nga të dyja palët. Në momentin e konstatimit u hartua kontrata e re po me të njëjtin afat. Kjo kontratë u ndërpre për shkak të kufizimeve ligjore për lojërat e fatit”.

Në mbështetje të këtyre deklarimeve subjekti ka depozituar dy kontratat e qirasë, si dhe deklaratë noteriale që justifikon vazhdimin e marrëdhënies së qirasë edhe për periudhën pa kontratë.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e subjektit, arrin në përfundimin se:

- Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme për të justifikuar marrëdhënien e qirasë për periudhën e pambuluar me kontratë.
- Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të provuar pagimin e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qirasë për periudhën 29.3.2007 – 28.3.2013 – 2.1.2016, nga qiradhënësi apo qiramarrësi, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për rrjedhojë, të ardhurat nga qiraja nuk janë marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara me burime të ligjshme financiare.

5. Djali G.H. - banesë me sip. 66.5 m², përfituar nga kontrata e shitblerjes e datës 24.6.2015, me nr. *, me vlerë 32,000 euro, me pjesë takuese që nuk është përcaktuar**

Burimi i krijimi: të ardhura të lëna nga gjyshja Xh.H. dhe kursimet familjare (shumë kjo e deklaruar më parë).

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës²⁴ ka konfirmuar pasurinë “apartament”, me sip. 66.5 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në L. “****”, Durrës, të regjistruar në emër të shtetasit G.H.

Kjo pasuri është përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 24.6.2015²⁵, me shitëse E.Ll. dhe blerës G.H., për çmimin 32,000 euro.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015 subjekti ka deklaruar se: “Djali G.H. ka tërhequr nga Union Bank, dega Durrës, dhe duke bërë nga ana jonë plotësimin, ka blerë banesë që ndodhet në L. ***, Shëtitorja ‘****’, ***, Kulla ***, Kati ***, Ap. ***, në vlerën 32,000 euro. Si burim krijimi është deklaruar: shpenzuar depozita në Union Bank 24,247 euro + pjesën e pakësimit të gjendjes së lekëve cash 1,700,000 lekë.”

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 32,000 euro, shumë kjo e krijuar me: të ardhura të lëna nga gjyshja Xh.H. dhe kursimet familjare.

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2019, ASHK, Drejtoria Vendore Durrës.

²⁵ Kontrata e shitblerjes së apartamentit me nr. ***, datë 24.6.2015.

Për të bërë analizën ligjore dhe financiare për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit të subjektit.

Komisioni, me pyetësonin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të specifikojë sa nga shuma prej 32,000 euro janë të ardhura të lëna nga gjyshja dhe sa janë kursime familjare.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Të ardhurat nga trashëgimia e gjyshes së djalit (nënës time) kanë qenë 30,000 USD, të depozituara nga ajo, në ‘Raiffeisen/Credins Bank’ dhe më pas të depozituara në euro pranë ‘Union Bank’ në shumën e 22.883 euro, nga investimi i të cilave janë fituar 889 euro (total 23.772 euro), diferenca është dhënë nga unë nga gjendja cash, që unë për shkak të mosshpërdorimit të tyre i konsideroj kursimet e familjes.*

a) Të ardhurat të lëna nga gjyshja janë të fituara si më poshtë:

- të ardhurat nga aktiviteti tregtar nga dyqani i privatizuar që nga viti 1992. Në vitet 1992 – 1994 aktiviteti tregtar kishte norma të larta fitimi. Sipas deklaramit verbal të prindërve të mi, fitimet e akumuluar në atë periudhë kanë qenë shumë të larta, prej të cilave unë kam trashëguar vlerat e deklaruara.
- sipas kontratës noteriale datë 10.10.1994, dyqani është dhënë me qira me një vlerë prej 750 USD/muaj deri më 9.10.1997. Totali i të ardhurave për këtë periudhë është 27,000 USD (750 USD x 3 vjet x 12 muaj).
*Me vendimet gjyqësore nr. ***, datë 22.9.1999, dhe nr. ***, datë 20.4.2000 (vendime të cilat janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe i referohen kontratës së qirasë me të njëjtin qiramarrës) janë fituar vlerat respektive prej 9,729 USD dhe 6,300 USD, me një total të ardhurash 16,029 USD.*
- të ardhura në vlerën 400,000 lekë nga shitja e dyqanit, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 19.5.2001.
- nëna ime ka përfituar si trashëgim një sipërfaqe toke të cilën e ka dhënë për investim dhe pjesën përfituese të ndërtimit (një dyqan me sip. 20 m² dhe një apartament me sip. 60 m²) e ka shitur direkt nëpërmjet firmës investitore dhe për këtë arsye nuk kam dokumente justifikuese për saktësinë e vlerave të shitjes.”

Subjekti deklaron se nuk disponon dokumente të shitjes së dyqanit me sip. 20 m² dhe apartamentit me sip. 60 m², pasi i ka shitur direkt nëpërmjet firmës investitore.

Në ILDKPKI subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes datë 18.10.2011²⁶, me shitës Xh.H. dhe blerës B.B. për dyqanin me sip. 20 m² me çmimin 2,219,040 lekë. Çmimi është parapaguar cash jashtë zyrës noteriale.

Për pjesën e kursimeve të familjes subjekti shpjegon se: *“Të ardhurat janë jo vetëm ato që trashëgova, por dhe nga paga ime, e bashkëshortes, si dhe të fëmijëve, të cilat në mënyrë specifike i kam deklaruar, duke depozituar dhe dokumentacionin përkatës.”*

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2015 subjekti ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit nga djali G.H., tërheqjen e shumës prej 24,247 euro nga llogaria në “Union Bank”.

Referuar dokumentacionit bankar, vënë në dispozicion nga “Union Bank”²⁷, rezulton se në datën 24.6.2015 shtetasi G.H. ka tërhequr nga llogaria e tij shumën prej 24,403 euro. Gjendja në këtë llogari është krijuar nga transferimi i shumës 22,883.37 euro nga llogaria në “Union Bank” e shtetases Xh.H., në datën 26.12.2012, me përshkrimin “dhuratë nga gjyshja”. Kjo shumë, deri në

²⁶ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 18.10.2011.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 30.9.2019, e “Union Bank”.

momentin e tërheqjes, është mbajtur nga shtetasi G.H. në formën e depozitës bankare me afat, duke gjeneruar edhe interesa.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 22,883 euro të dhuruar nga shtetasja Xh.H. nëpërmjet transferimit bankar në “Union Bank”, Komisioni ka analizuar të gjitha burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume të deklaruara nga subjekti si më sipër.

b) Kursimet familjare

Subjekti ka deklaruar se për pjesën e mbetur është përdorur pjesa e pakësuar nga gjendja *cash* në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015.

Në deklaratën periodike të vitit 2015 subjekti deklaron: “*Gjendje aktuale e parave në cash është 1,700,000 lekë nga akumulimi i të ardhurave dhe nga shpenzimet për blerjen e apartamentit nga djali G.H.*”.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2014 subjekti deklaron gjendje *cash* shumë prej 3,200,000 lekësh.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2015 subjekti deklaron gjendje *cash* shumë prej 1,700,000 lekësh.

Referuar deklaramentit duket se subjekti ka pakësuar kursimet e tij *cash* me shumë 1,500,000 lekë.

Në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes *cash* Komisioni ka analizuar ligjshmërinë e tij sipas burimit të deklaruar nga subjekti.

Si burim për krijimin e kursimeve *cash* kanë shërbyer të ardhurat e trashëguara nga babai, për të cilat subjekti nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të tyre (shihni analizën në pikën 10 të vendimit).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, pasi i kaloi barrën e provës, i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga gjyshja Xh.H., si dhe nga kursimet familjare.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me krijimin e shumës 22,833 euro, si burim i krijimit të shumës 32,000 euro, ka shpjeguar se:

- i. Aktiviteti tregtar i Xh.H. 1992 - 1994: “... *aktiviteti tregtar i Xh.H. vërtetohet me shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës e datës 13.12.2019*²⁸. Në bazë të ligjit të kontabilitetit detyrimi ligjor për ruajtjen e dokumenteve financiare është deri në 10 vjet. Aktiviteti tregtar është realizuar dhe mbyllur para 20 viteve dhe nuk ka më detyrim ligjor për ruajtjen e dokumenteve tatimore dhe kontabël.... Sipas legjislacionit tatimor të kohës, për shkak të mënyrës së mbajtjes së të dhënave nga organet tatimore nuk ka pasur afate të qartë për pagimin e detyrimeve për të ardhurat nga qiraja. Duke pasur parasysht korrektesën dhe integritetin e prindërve të mi, në momentin që ka lindur detyrimi ligjor për pagesën e tatimit të qirasë ky detyrim tatimor do të jetë paguar sipas ligjit në fuqi”.
- ii. Të ardhurat nga qiraja për periudhën 10.10.1994 – 9.10.1997: “... *sipas kontratës noteriale datë 10.10.1994 dyqani është dhënë me qira me një vlerë 750 USD/muaj deri më 9.10.1997. Totali i të ardhurave për këtë periudhë është i barabartë me 27.000 USD (750 USD x 3 vjet x 12 muaj). Shkresa nr. *** prot., datë 13.12.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, ku konfirmon se Xh.H. ka paguar tatim qiraje për periudhën 1996 – 1998 në vlerën 316,194 lekë.*

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 13.12.2019, e DRT-së Durrës ku konfirmon se Xh.H. ka pasur kod fiskal nr. ***.

- iii. Të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor: “Me vendimet gjyqësore nr. ***, datë 22.9.1999 dhe nr. *** datë 20.04.2000 (vendime të cilat janë të lidhura me njëri tjetrin dhe i referohen kontratës së qirasë me të njëjtin qiramarrës) janë fituar vlerat respektive prej 9.729 USD dhe 6.300 USD, me një total të ardhurash 16.029 USD. Ekzekutimi i këtyre vendimeve është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e palës qiramarrëse Z. G.K. dhe ky fakt vërtetohet me deklaratën noteriale me nr. ***, datë 14.12.2019.
- iv. Të ardhurat në shumën 400,000 lekë nga shitja e dyqanit të Xh.H.: “Dyqani i është shitur motrave të mia dhe si provë shkresore, paraqes vërtetimet hipotekore”.
- v. Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive, dyqan me sip. 20 m² dhe apartament me sip. 60 m² të disponuara nga nëna e subjektit: “Me kontratën e shitblerjes së dyqanit datë 18.10.2011 shitësja Xh.H. ia shet blerësit B.B. dyqanin me sip. 20 m² shitur me çmimin 2,219,040 lekë i parapaguar cash jashtë kësaj zyre. Sipas kësaj kontrate çmimi i shitjes për m² është 110,952 lekë (2,219,040 lekë/20 m²). Në lidhje me shitjen e apartamentin me sip. 60 m², siç e kam theksuar nuk e disponoj këtë kontratë dhe duke iu referuar çmimit të shitjes së dyqanit, çmimi i shitjes së apartamentit është 55,476 lekë/m², duke qenë se çmimi i apartamentit si rregull është dyfish më i ulët se çmimi dyqanit dhe për rrjedhojë ka një të ardhur nga kjo shitje prej 3,328,560 lekë (110,952 lekë/2 x 60 m²). Është e konfirmuar që të gjitha apartamentet dhe dyqanet e këtij pallati janë të shitura dhe të hipotekuara të blerësit”.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me krijimin e shumës 8,000 euro, si burim i krijimit të shumës 32,000 euro, ka shpjeguar se: “...diferenca prej rreth 8,000 euro është nga kursimet e tjera të familjes time të trashëguara nga prindërit (vlerat 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro), mbas vdekjes së babait në vitin 2009, dhe të deklaruara në deklaratën e po këtij viti”.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i rivlerësimit dhe shpjegimet e subjektit, arrin në konkluzionin se:

Për të ardhurat e dhuruara nga gjyshja në shumën 22,883 euro si burim i krijimit të shumës 32,000 euro

- i. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i znj. Xh.H. për periudhën 1992 – 1994, Komisioni vlerësoi se:
 - Subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar në vlerë monetare të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i Xh.H. që përfshihen tek pjesa e të ardhura që i janë dhuruar djalit të subjektit G.H.;
 - Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, datë 13.12.2019, e paraqitur si provë nga subjekti për të provuar aktivitetin e ushtruar nga Xh.H., nuk konfirmon të ardhura të realizuara nga Xh.H. për periudhën 1992 – 1994;
- ii. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiraja nga znj. Xh.H. në shumën 27,000 USD për periudhën 10.10.1994 – 9.10.1997, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor pagimin e detyrimeve tatimore për shumën e përfituar nga dhënia me qira e dyqanit nga znj. Xh.H. si individ, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës²⁹. Tatimi mbi qiranë i paguar në shumën 316,194

²⁹ Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

lekë i referohet aktivitetit të ushtruar nga znj. Xh.H. me kod fiskal *** për periudhën 1996 –1998 dhe nuk i referohet kontratës së qirasë për periudhën 1994 –1997, ku pretendohet që znj. Xh.H. ka përfituar shumën 27,000 USD

- iii. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor ku znj. Xh.H. ka përfituar shumat 9.729 USD dhe 6.300 USD, me një total të ardhurash 16,029 USD, duke marrë në konsideratë deklaratën noterile të datës 14.12.2019³⁰ lëshuar nga shtetasi G.K. në cilësinë e qiramarrësit të dyqanit, që ka ekzekutuar vendimin e gjykatës në mënyrë vullnetare, Komisioni i vlerëson si të ardhura të ligjshme të përfituara nga burime të ligjshme në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iv. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga znj. Xh.H. në shumën 400,000 lekë nga shitja e dyqanit të saj, subjekti depozitoi në cilësinë e provës që ky veprim juridik është kryer, dy vërtetime hipotekore në emër të blerësve T.M. dhe D.Ç.
- v. Komisioni e konsideroi të plotë dokumentacionin e depozituar nga subjekti që vërtetonte shitjen e dyqanit të znj. Xh.H. dhe përfitimin e shumës prej 400,000 lekësh.
- vi. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive, dyqan me sip. 20 m² dhe apartament me sip. 60 m² të disponuara nga nëna e subjektit, Komisioni vlerësoi se:
 - Shitja e dyqanit me sip. 20 m² dhe përfitimi i shumës 2,219,040 lekë nga shitja e tij provohet me kontratën e shitblerjes datë 18.10.2011³¹ të depozituar më herët nga subjekti në ILDKPKI, për rrjedhojë, Komisioni i konsideron të plota shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti duke e konsideruar si të ardhur të ligjshme të përfituar me burime financiare të ligjshme shumen prej 2,219,040 lekë.
 - Në lidhje me shitjen e apartamentit me sip. 60 m² nga znj. Xh.H., shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk janë bindëse dhe për më tepër nuk provohet me dokumentacion ligjor kryerja e këtij transaksioni.

Për kursimet familjare në shumën 8,000 euro si burim i krijimit të shumës 32,000 euro

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka provuar me dokument justifikues ligjor burimin e ligjshëm të shumës së trashëguar nga babai në vitin 2009 në shumat 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro, shuma këto që kanë shërbyer për krijimin e kursimeve në cash të deklaruara nga subjekti në deklaratën periodike në vlerat 3,000,000 lekë dhe 21,000 euro (shihni analizën në pikën 10 të këtij vendimi).

6. Të ardhura nga qiraja e apartamentit të djalit G.H. në shumën 2,860 euro

Subjekti ka depozituar kontratën e qirasë së datës 28.09.2015³² me qiradhënës G.H. dhe qiramarrës shoqëria “***” sh.p.k., me objekt dhënie me qira e apartamentit me sip. 65.50 m² në adresë: L. **, Rr. “***”, Durrës, me qira mujore 220 euro/muaj.

Ky apartament jepet me qira për një periudhë 1- vjeçare që llogaritet nga data 21.8.2015.

Subjekti ka depozituar pagesat e bëra nga shoqëria “***” sh.p.k., për pagimin e tatimit në burim për qiradhënien për periudhën tetor 2015 – shtator 2016.

Nga pagesat e qirasë së kryera nga shoqëria “***” sh.p.k., për llogari të z. G.H. në llogarinë e tij bankare në BKT rezulton se pagesat e përfituara nga qiraja nga gushti 2015 deri në tetor 2016 janë në shumën 2,660 euro.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

³⁰ Deklarata noteriale nr. ***, datë 14.12.2019 me deklarus G.K., i cili deklaroi se ka përmbushur detyrimin në mënyrë vullnetare pa u investuar zyra e përmbarimit për ekzekutimin e këtij detyrimi sipas vendimit gjyqësor.

³¹ Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 18.10.2011, me shitëse Xh.H. dhe blerëse B.B. për dyqanin me sip. 20 m² me çmimin 2,219,040 lekë.

³² Kontrata e qirasë nr. ***, datë 28.9.2015 me qiradhënës G.H. dhe qiramarrës “***” sh.p.k.

Komisioni vlerëson se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e depozituar prej tij dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këto të ardhura.

7. Djali G.H. - automjet tip “Benz” me targa *, i blerë sipas kontratës nr. ***, datë 21.11.2011, në vlerën 10, 200 euro, me pjesë takuese që nuk është përcaktuar**

Burimi i krijimit: të ardhurat e subjektit dhe nga shitja e automjeteve që subjekti ka pasur më parë.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011 subjekti ka deklaruar: *“Kam ndërruar makina dhe përkatësisht kam shitur dhe blerë 3 automjete të cilat ja kam blerë shtetasit A.G. dhe shitur shtetasve F.K. dhe V.L. me banim në Durrës dhe A.O. me banim në Tiranë dhe disponoj makinën me targa *** ku në lejen e qarkullimit kam shtuar emrin e djalit”.*

DPSHTRR-ja³³ ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Mercedes-Benz, E280CDI” i vitit 2007, nga ku rezulton se automjeti është shitur në datën 13.11.2011 nga shoqëria gjermane “****”, shtetasi A.G., për çmimin 10,200 euro. Dokumenti doganor i datës 17.11.2011 pasqyron faktin se shtetasi A.G. ka paguar taksën doganore në shumën 297,674 lekë (sipas çmimit 10,200 euro llogaritet 141,75 lekë kursi i këmbimit).

Me kontratën e shitblerjes datë 21.11.2011³⁴, shtetasi A.G. ia ka shitur blerësit Edmond Hyka automjetin tip “Mercedes-Benz, E280CDI”, i vitit 2007, për çmimin 10,200 euro.

Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti nga shitësi A.G., i cili 3 ditë pasi e ka sjellë automjetin në Shqipëri ia ka shitur subjektit me çmimin 10,200 euro me çmimin që ai e ka blerë vetë, ndërkohë që taksa doganore në shumën 297,674 lekë është paguar nga shtetasi A.G., pra, rezulton ta ketë shitur me humbje, duke ngritur për një situatë trajtimi preferencial ndaj subjektit të rivlerësimit.

Komisioni gjithashtu i ka kërkuar shpjegime subjektit nëse ka njohje dhe shoqëri me shtetasin A.G.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Unë nuk e kam ditur se sa i ka kushtuar automjeti z. A.G., por unë atë e kam blerë aq sa është pasqyruar realisht në kontratë në shumën 10,200 euro, pasi ky ishte çmimi i tregut për këtë tip dhe model makine.*

*Shtetasin A.G. e kam njohur nëpërmjet miqve të përbashkët përpara vitit 2000. Marrëdhëniet me të kanë qenë normale, edhe kur djali im u punësua në punë me kërkesën time në shoqërinë që ai administronte ‘***’ sh.p.k. Pikërisht gjatë kësaj kohe, kur ai sillte dhe automjete për të shitur, unë kam bërë edhe blerjen e automjetit. Shoqëria me këtë person ende vazhdon.”*

Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë dhe shtetasin A.G. dhe nga korrespondenca e kryer me Prokurorinë e Apelit Durrës dhe Prokurorinë e Apelit Tiranë³⁵ nuk ka rezultuar ndonjë situatë e tillë.

Në datën 15.11.2011 subjekti i rivlerësimit ka shitur me kontratën nr. *** automjetin tip. “Benz 220 CDI”, me çmimin 10,000 euro.

³³ Shkresa nr. *** prot., datë 24.9.2019, e DPSHTRR-së.

³⁴ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 21.11.2011.

³⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 2.12.2019, Prokuroria e Apelit Durrës; shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2019, Prokuroria e Apelit Tiranë.

Subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz E280CDI” në datën 21.11.2011, me çmimin 10,200 euro, të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në shumën 10,000 euro.

Qëndrimi i subjektit në lidhje konstatimet e Komisionit

Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit, i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me konstatimet e Komisionit se çmimi në kontratën e shitjes nuk është çmimi real dhe se kemi të bëjmë me çmim preferencial.

Subjekti, në prapësimet e dhëna prej tij pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka shpjeguar se: *“... në lidhje me konstatimin tuaj, për një trajtim preferencial, ky konstatim nuk është i drejtë, pasi automjeti nuk është i ri, por i përdorur dhe për rrjedhojë gjithmonë qëndron rreziku qoftë për shitësin qoftë për blerësin që të këtë zhvlerësim. Ju vëmë në dijeni se edhe sot një makinë të re, mbas 6-mujsh i bie vlera (zhvlerësohet) deri në 30 %. Marrëdhënia me këtë person është normale edhe pse djali është shkëputur nga marrëdhënia e punësimit me të”*.

Një linjë arsyetimi të ngjashme me atë të subjektit ka dhënë edhe përfaqësuesi i tij ligjor në seancën dëgjimore.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, si dhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe të plota.

Referuar deklaramentit të subjektit, zhvlerësimi i këtij automjeti konstatohet se ka ndodhur brenda 3 ditësh në shumën 297,674 lekë, pa llogaritur edhe shpenzimet e transportit të automjetit nga shteti gjerman në Shqipëri, zhvlerësim i cili nuk ndodh në një situatë reale shitblerjeje për një periudhë kaq të shkurtër kohore. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar trajtimin preferencial në deklaratën e pasurisë të vitit 2011, që ka të bëjë me shitjen e automjetit nga shitësi subjektit të rivlerësimit me një vlerë më të ulët se çmimi i blerjes + shpenzimet doganore dhe ato të transportit, duke sjellë pasaktësi në deklarament.

8. Të ardhura të fituara nga puna si avokat në shumën 10,000,000 lekë

Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Gjatë viteve që kam punuar si avokat kam nxjerrë të ardhura në shumën rreth 10,000,000 lekë nga 1998 - maj 2005.”*

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)³⁶ konfirmon se shtetasi Edmond I. Hyka, i datëlindjes 1960, figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 8.2.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilin nuk mund të identifikohet pajisja me NUIS.

Me vendimin nr. ***, datë 28.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton të jetë çregjistruar subjekti i mësipërm.

³⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 27.9.2019, e QKB-së.

QKB-ja gjithashtu konfirmon se shtetasi Edmond Hyka, i biri i I., i datëlindjes 1961 (dhe jo i 1960) figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 1.11.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Drejtoria Tatimore Durrës³⁷ ka konfirmuar se pas verifikimit në sistemin C@TS rezultoi i regjistruar tatimpaguesi Edmond Hyka me NIPT ***, me administrator Edmond Hyka, me objekt veprimtarie aktivitete juridike, me adresë: Rr. “****”, L. ***, Durrës me status “kërkesë për çregjistrim nga data 28.12.2005.

Për periudhën e zhvillimit të aktivitetit subjekti ka qenë me përgjegjësi tatimore biznes i vogël pa TVSH. Parashikimi dhe qarkullimi në vite paraqitet si vijon:

Viti	Parashikimi deri në 2,000,000 lekë	Qarkullimi	Shënime
2000	800,000	1,100,000	Të dhëna nga dokumentacioni në arkivë. Nuk ka detyrimin ligjor për deklarimin e fitimit.
2001	1,100,000	1,420,000	Të dhëna nga dokumentacioni në arkivë. Nuk ka detyrimin ligjor për deklarimin e fitimit.
2002	1,300,000	687,500	Të dhëna nga dokumentacioni në arkivë. Nuk ka detyrimin ligjor për deklarimin e fitimit.
2003	687,500	Nuk ka deklarim	Të dhëna nga dokumentacioni në arkivë. Nuk ka detyrimin ligjor për deklarimin e fitimit.
2004	688,000	600,000	Të dhëna nga dokumentacioni në arkivë. Nuk ka detyrimin ligjor për deklarimin e fitimit.
2005	1,500,000	375,000	Të dhëna nga dokumentacioni në arkivë dhe nga sistemi c@ts.
2006	---	0	Të dhëna nga sistemi c@ts

Deklaruar kontribute	Paguar kontribute	Periudha	Data e pagesës
10,989	10,989	Mars 2005	1.4.2005

Komisioni ka konstatuar se subjekti në deklaratën e pasurisë të vitit 2004 ka deklaruar të ardhura nga puna si avokat për vitet 1998 - 2005, ndërkohë që QKB-ja konfirmon shtetasin Edmond Hyka, i datëlindjes 1960, i cili figuron i regjistruar me aktivitet avokat me vendim gjykate në datën 1.11.1999 dhe shtetasin Edmond Hyka, i datëlindjes 1961, i cili figuron i regjistruar me aktivitet avokat me vendim gjykate në datën 8.2.2000. Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me periudhën e saktë të ushtrimit të aktivitetit të avokatit

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “Unë jam i ditëlindjes 21.6.1960, ...aktivitetin e avokatisë e kam ushtruar në periudhën 2000 – deri në maj 2005”.

Drejtoria Tatimore Durrës nuk ka dërguar informacion në lidhje me fitimin e realizuar, duke konfirmuar se për shkak të përgjegjësisë tatimore si biznes i vogël, subjekti tregtar nuk ka pasur detyrim për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe fitimit të realizuar.

Komisioni, për llogaritjen e fitimit është bazuar në qarkullimin faktik sipas shkresës së Zyrës së Tatimeve dhe normën e fitimit për këtë lloj aktiviteti, e cila është llogaritur në masën 80 %. Të ardhurat nga aktiviteti si avokat për periudhën 2000 - 2002, që kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurive, si dhe ato deri në vitin 2005, paraqiten si më poshtë:

³⁷ Drejtoria Tatimore Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2019, ka vënë në dispozicion të dhëna tatimore nga viti 2000-2005, ku përfshihet parashikimi dhe qarkullimi.

Viti	Qarkullimi i parashikuar	Qarkullimi	Fitimi
2000	800,000	1,100,000	880,000
2001	1,100,000	1,420,000	1,136,000
2002	1,300,000	687,500	550,000
2003	687,500	0	0
2004	688,000	600,000	480,000
2005	1,500,000	375,000	300,000
Total	6,075,500	4,182,500	3,346,000

Qëndrimi i subjektit në lidhje konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të vërtetuar me dokumentacion ligjor:

- i. ushtrimin e aktivitetit të avokatisë;
- ii. pagimin e detyrimeve tatimore për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2000 - 2005;
- iii. të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë në shumën 10,000,000 lekë sipas deklaramit të tij.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka shpjeguar si vijon:

- i. *Drejtoria Tatimore Durrës³⁸ konfirmon periudhën e ushtrimit të aktivitetit 2000 – maj 2005, ndërsa vendimi gjyqësor³⁹ i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës konfirmon çregjistrimin e personit fizik. Këto dy fakte vërtetojnë ushtrimin e aktivitetit të avokatisë.*
- ii. *Fakti që deri sot nuk kam pasur ndonjë njoftim vlerësimi apo njoftim për të paguar detyrime, vërteton që detyrimet tatimore janë të likuiduara plotësisht, e konfirmuar kjo edhe nga DRT-ja Durrës.*
- iii. *Në atë periudhë ka pasur paqartësi ligjore nga të gjitha subjektet e shkallës tatimore me qarkullim të parashikuar deri në vlerën 2,000,000 lekë nëse duhej të bëhej deklarami i të ardhurave apo jo.*

Tatimi i paguar ishte për një qarkullim të përcaktuar në vlerën 2,000,000 lekë dhe, për rrjedhojë, nuk kishte rëndësi deklarami mbi të ardhurat.

Shkresa e DRT-së Durrës konfirmon se të ardhurat për këtë periudhë janë në shumën 8,875,500 lekë, të cilave po t'u zbritet pjesa e shpenzimeve 20 % (sipas llogaritjeve tuaja) me vlerë 1,775,000 lekë rezulton me një fitim neto prej 7,100,000 lekësh. Diferenca në deklaram nga 10,000,000 lekë në 8,875,500 lekë, vjen si rrjedhojë e mangësive në njohuritë financiare dhe kontabël. Në bazë të ligjit të kontabilitetit detyrimi ligjor për ruajtjen e dokumenteve financiare është deri në 10 vjet. Meqenëse nga viti 2005, vit i fillimit të detyrës deri në vitin 2015 nuk më janë nxjerrë probleme në deklaram, këtë dokumentacion nuk e disponoj më, pasi kishte kaluar detyrimi ligjor për ruajtjen e tyre dhe e kam konsideruar të pavlefshëm ruajtjen e mëtejshme të tyre”.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, pas dërgimit të barrës së provës në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të avokatisë dhe pagimin e detyrimeve tatimore për ushtrimin e këtij aktivitetit, arrin në konkluzionin se:

³⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 11.7.2017, e DRT-së Durrës.

³⁹ Vendimin nr. ***, datë 28.12.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

- i. Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe ka provuar me dokumentacion provues ligjor periudhën kohore të ushtrimit të aktivitetit të avokatisë. Gjithashtu, nga DRT-ja Durrës⁴⁰ është konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka detyrime tatimore 0 (zero) lekë.
- ii. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor në lidhje me të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë në shumën 10,000,000 lekë, të deklaruara në deklaratën “Vetting”. Subjekti i referohet vlerës prej 8,875,500 lekësh të pretenduar si qarkullim faktik i realizuar⁴¹ (kjo shumë vjen nga mbledhja matematikore e kryer nga subjekti - i qarkullimit të parashikuar në vlerën 2,000,000 lekë për vitet 2000 – 2002 dhe shumëve 687,500 për vitin 2003, 688,000 lekë për vitin 2004 dhe 1,500,000 lekë për vitin 2005, me përkrahimin “tabela e llogaritjes së taksës vendore” të përkrahura në shkresën e DRT-së Durrës), ndërkohë që sipas informacionit të përcjellë po nga DRT-ja Durrës, kjo shumë përfaqëson qarkullimin e parashikuar për t’u realizuar, të deklaruar nga subjekti gjatë viteve të ushtrimit të aktivitetit.
- iii. Komisioni vlerëson se, duke marrë në konsideratë informacionin e vënë në dispozicion nga DRT-ja Durrës⁴², subjekti ka kryer qarkullim faktik të realizuar për vitet 2000, 2001, 2002, 2004 dhe 2005 në shumën totale 4,182,500 lekë, ndërsa për vitin 2003 DRT-ja Durrës nuk konfirmon qarkullim faktik të realizuar (të pasqyruar në tabelën në pikën 8 të vendimit).
- iv. Si rrjedhojë, Komisioni bazuar në qarkullimin faktik të realizuar, të konfirmuar nga DRT-ja Durrës, ka llogaritur fitimin *neto* të realizuar nga subjekti i rivlerësimit për ushtrimin e aktivitetit të avokatisë në masën 80 % të qarkullimit faktik të realizuar (kjo sipas metodologjisë së ndjekur nga Komisioni në rastet e ngjashme, (të pasqyruar në tabelën në pikën 8 të vendimit).
- v. Komisioni nuk mori në konsideratë deklarimin e subjektit në deklaratën “Vetting” se ka përfitur nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë të ardhura në shumën prej 10,000,000 lekësh dhe as deklarimin e subjektit në prapësimet e tij për realizimin e të ardhurës në shumën prej 8,875,500 lekësh në vlerë *bruto* ose 7,100,000 lekë në vlerë *neto*, por njohu si të ardhura të ligjshme nga subjekti, shumën e përfiturar në vlerën 3,346,000 lekë.

9. Të ardhura të fituara nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në shumën 418,440 lekë

Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 14.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku është dëmshpërblyer me pagën e një viti pune si rezultat i lirimit nga detyra e prokurorit (larguar nga detyra me dekretin nr. ***, datë 8.10.1999 largim nga detyra me motivacion “për shkelje të ligjit”, por në vendim nuk parashikohet shuma e përfiturar).

Prokuroria e Përgjithshme me urdhrin nr. ***, datë 3.7.2002, “Për zbatimin e vendimit nr. ***, datë 14.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, ka urdhëruar “të bëhet likuidimi i detyrimit që rrjedh nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 14.12.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pagesën e z. Edmond Hyka, ish-prokuror në Prokurorinë e Rrethit Durrës me pagën e një viti”.

Sipas borderosë nga dega e financës, rezulton se z. Edmond Hyka është paguar me vlerën 418,440 lekë.

⁴⁰ Shkresa e Drejtorisë Tatimore Durrës me nr. *** prot., datë 11.7.2017, ku në pjesën e fundit të kësaj shkrese nga ky institucion konfirmohet se “... Subjekti ka detyrime në kohë reale 0 (zero), datë 10.7.2017”.

⁴¹ Sipas shkresës Drejtoria Tatimore Durrës me nr. *** prot., datë 11.07.2017, të depozituar nga subjekti pas dërgimit të përgjigjeve të rezultateve të hetimit.

⁴² Shkresa nr. *** prot., datë 10.10.2019, e DRT-së Durrës.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë, duke e konsideruar të plotë dokumentacionin provues në lidhje me këtë deklaram.

10. Vlera monetare të trashëguara nga babai I.H. në shumën prej 5,000,000 lekësh dhe 35,000 euro, vërtetuar me deklaratën noteriale të datës 12.3.2010

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009 subjekti ka deklaruar: *“Të trashëguar nga babai I.H. në datën 12.2.2009, shumën 5,000,000 lekë nga të cilat 1,500,000 lekë i janë shtuar depozitës së bashkëshortes E. depozituar si bono thesari dhe 35,000 euro nga të cilat 11,000 euro janë depozituar në “Fibank” në emrin tim dhe të vjehrrës 3000 euro, po te kjo bankë në emrin tim dhe pjesa tjetër prej 21,000 euro cash edhe shuma 3,000,000 lekë, cash”*.

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 12.3.2010⁴³ me deklarues shtetas Xh.H., T.M. dhe D.Ç., të cilat deklarojnë se me vendimin e gjykatës së datës 9.6.2009 janë trashëgimtare të z. I.H., i cili para vdekjes zotëronte pasuritë dhe vlerat monetare të mëposhtme:

- i. Shuma 35,000 euro nga të cilat 10,000 euro kanë qenë të depozituara në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe 25,000 euro gjendje në shtëpi.
- ii. Shuma prej 5,000,000 lekësh e depozituar në banka të ndryshme.
- iii. Banesë me vendndodhje në Durrës, L. ***, Rr. “****”, e cila është në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së Durrës.

Në lidhje me zotërimin e shumës prej 35,000 euro dhe 5,000,000 lekë nga babai i subjektit, përpara se kjo shumë t’i kalonte me trashëgimi subjektit

Sipas deklaratës noteriale të datës 12.3.2010 është deklaruar se babai i subjektit ka disponuar shumën 35,000 euro, nga të cilat 10,000 euro kanë qenë të depozituara në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe 25,000 euro gjendje në shtëpi, si dhe shuma prej 5,000,000 lekësh e depozituar në banka të ndryshme.

Nga informacioni i përcjellë nga banka⁴⁴ konfirmohet depozita në shumën prej 10,000 euro në emër të z. I.H. në datën 31.12.2008. Gjithashtu, nga bankat konfirmohet se shtetasi I.H. ka disponuar llogari depozite dyemërore me subjektin Edmond Hyka në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 3,000,000 lekë⁴⁵.

Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogarinë dyemërore me babanë në shumën 3,000,000 lekë dhe me pjesë takuese 100 %.

Subjekti, gjatë hetimit, në lidhje me kontributin e tij në shumën 3,000,000 lekë ka deklaruar se: *“Shuma e investuar është kryesisht nga kursimet e aktivitetit si avokat, si dhe të ardhura nga babai dhe nëna. Mendoj që mbi 75-80 % është nga aktiviteti i avokatisë”*.

Gjithashtu, konfirmohet nga korrespondenca me bankat edhe llogaria dyemërore në “Alpha Bank” në shumën 1,300,000 lekë, e mbyllur më 23.7.2012⁴⁶.

⁴³ Deklarata noteriale nr. ***, datë 12.3.2010.

⁴⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 24.9.2019, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁴⁵ Shuma prej 3,000,000 lekësh është depozituar në llogari depozite me afat në datën 27.9.2005. Me mbarimin e afatit 1-vjeçar depozitat janë rinovuar deri më 30.9.2009. Në datën 30.9.2009 rezulton e tërhequr shuma prej 4,321,400 lekësh.

⁴⁶ Kjo depozitë nga përgjigjet e pyetësorit nr. 2 rezulton të jetë hapur në datën 8.5.2008. Në deklaratën periodike të vitit 2008 subjekti nuk ka deklaruar krijimin e kësaj depozite.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me mosdeklarimin e depozitës prej 1,300,000 lekësh në deklaratën e pasurisë së vitit 2008.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: *“Kjo depozitë është hapur nga babai im dhe unë nuk kam qenë në dijeni. Në momentin e marrjes dijeni për faktin lartpërmendur, bëra deklarin në periudhën përkatëse.”*

Analizë e mundësisë financiare e babait të subjektit për krijimin e shumave 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me vlerat monetare të trashëguara nga babai I.H., duke specifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre dy shumave, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor këtë burim të ligjshëm.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: *“Siç e kam theksuar në deklarinet e mëparshme prindërit e mi, nga privatizimi përfituan një dyqan. Në këtë dyqan ata zhvilluan aktivitet tregtar dhe më pas e kanë dhënë me qira, si dhe e kanë shitur. Gjithashtu, ata kanë blerë dhe shitur një apartament. Ndërsa nëna ime ka përfituar si trashëgim një sipërfaqe toke të cilën e ka dhënë për investim dhe pjesën përfituese të ndërtimit e ka shitur. Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 18.3.1996, të ndryshuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 31.7.1996, në vlerën 2,143,491 lekë, lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. ***, datë 28.1.1997.*

*Të ardhura nga shitja e një apartamenti me vlerë 2.000.000 lekë, sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 17.9.2004.”*

Subjekti ka depozituar dhe shpjeguar dokumentacionin ligjor për burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave:

- i. *praktika e privatizimit të dyqanit nga ana e nënës, sipas vërtetimit hipotekor datë 1.7.1992, ku specifikohet kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 30.6.1992;*
- ii. *kontrata e qirasë së dyqanit nr. ***, datë 10.10.1994, sipas një vlere 750 USD/muaj deri më 9.10.1997. Totali i të ardhurave për këtë periudhë është i barabartë me 27.000 USD (750 USD x 3 vjet x 12 muaj);*
- iii. *vendimet gjyqësore nr. ***, datë 22.9.1999 dhe nr. ***, datë 20.4.2000 (të cilat i referohen kontratës së qirasë me të njëjtin qiramarrës) janë fituar vlerat respektive prej 9.729 USD dhe 6.300 USD, me një total prej 16.029 USD;*
- iv. *në vitin 2001 janë përfituar 400.000 lekë nga shitja e dyqanit, sipas kontratës së shitjes nr. *** kol., *** datë 19.5.2001;*
- v. *nëna ime ka përfituar si trashëgim një sipërfaqe toke të cilën e ka dhënë për investim dhe pjesën përfituese të ndërtimit (një dyqan me sip. 20 m² dhe një apartament me sip. 60 m²) e ka shitur direkt nëpërmjet firmës investitore dhe për këtë arsye nuk kam dokumente justifikuese për saktësinë e vlerave të shitjes;*
- vi. *vendimi gjyqësor nr. ***, datë 18.3.1996, i ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 31.7.1996, në vlerën 2,143,491 lekë dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. ***, datë 28.1.1997, ku babai ka fituar dëmshpërblim;*
- vii. *kontrata noteriale nr. ***, datë 17.9.2004, për shitjen e apartamentit me vlerë 2,000,000 lekë;*
- viii. *mandatpagesa nga Banka e Kursimeve (sot Raiffeisen), të kryera gjatë viteve 1997-1998, ku pasqyrohen veprimet e hapjes së depozitave në valuta të ndryshme dhe tërheqje interesash nga ana e babait. Për shkak të kohës së largët dokumente të tjera nuk disponoj.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, pasi i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime në lidhje me mospërputhjen mbi disponimin nga babai I.H., të shumave 35,000 euro dhe 5,000,000 lekë, subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.3.2010 të dhurimit, si rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë, termi i përdorur “shuma 5,000,000 lekë të depozituara në banka të ndryshme” i referohet dy depozitave që i kam pasur në emrin tim dhe të babait pranë Bankës ‘Intesa Sanpaolo’ rreth 4,200,000 lekë (të kaluar më vonë në investime bono thesari) dhe tek ‘Alpha Bank’ 1,300,000 lekë. Pra, nga vdekja e babait kam trashëguar vlerën monetare cash prej 5,000,000 lekësh dhe 3,000 euro, të cilat që në vitin 2009, përpara deklaratës noteriale të mësipërme, i kam kaluar 1,500,000 lekë në depozitën në emër të bashkëshortes, 3,000,000 lekë gjendje cash dhe 21,000 euro përsëri gjendje cash, si dhe 14,000 euro të depozita në llogaritë e depozitave në emrin tim dhe të vajzës sime I.”

Gjithashtu, Komisioni, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumave të trashëguara 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit, ka dhënë shpjegime:

- i. në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i prindërve në vitet 1992 - 1994⁴⁷;
- ii. në lidhje me të ardhurat nga qiraja e dyqanit të privatizuar më parë nga Xh.H., për periudhën 10.10.1994 – 9.10.1997⁴⁸;
- iii. në lidhje me shumat e përfituara nga vendimet gjyqësore nr. ***, datë 22.9.1999 dhe nr. *** datë 20.4.2000⁴⁹;
- iv. të ardhura në vlerën 400,000 lekë nga shitja e dyqanit, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 19.5.2001⁵⁰;

⁴⁷ Aktiviteti tregtar kishte norma të larta fitimi. Sipas deklaramit verbal të prindërve të mi, fitimet e akumuluar në atë periudhë kanë qenë shumë të larta, prej të cilave unë kam trashëguar vlerat e deklaruara. Aktiviteti tregtar i Xh.H. vërtetohet me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, ku konfirmon se Xh.H. ka pasur një kod fiskal me nr. ***.

⁴⁸ Sipas kontratës noteriale datë 10.10.1994, dyqani është dhënë me qira me një vlerë 750 USD/muaj deri më 9.10.1997. Totali i të ardhurave për këtë periudhë është i barabartë me 27.000 USD (750 USD x 3 vjet x 12 muaj). Shkresa nr. *** prot., datë 13.12.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, ku konfirmon se Xh.H. ka paguar tatim qiraje për periudhën 1996 – 1998 në vlerën 316,194 lekë. Sipas legjislacionit tatimor të kohës, për shkak të mënyrës së mbajtjes së të dhënave nga organet tatimore nuk ka pasur afate të qarta për pagimin e detyrimeve për të ardhurat nga qiraja. Duke pasur parasysh korrektesën dhe integritetin e prindërve të mi, mendoj që në momentin që ka lindur detyrimi ligjor për pagesën e tatimit të qirasë ata do të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore sipas ligjit në fuqi.

⁴⁹ Me vendimet gjyqësore nr. ***, datë 22.9.1999 dhe nr. *** datë 20.4.2000 (vendime të cilat janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe i referohen kontratës së qirasë me të njëjtin qiramarrës) janë fituar vlerat respektive prej 9.729 USD dhe 6.300 USD, me një total të ardhurash prej 16.029 USD. Ekzekutimi i këtyre vendimeve është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e palës qiramarrëse, z. G.K. dhe ky fakt vërtetohet me deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.12.2019.

Shkresa nr. *** prot., datë 13.12.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, ku konfirmon se Xh.H. ka paguar tatim qiraje për periudhën 1996 – 1998, në vlerën 316,194 leke. Për vendimet gjyqësore nuk paguhet tatim.

⁵⁰ Dyqani i është shitur motrave të mia dhe si provë shkresore paraqes vërtetimet hipotekore në emër të D.Ç. dhe T.M.

- v. të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive, dyqan 20 m² dhe apartament 60 m², të disponuara nga nëna e subjektit sipas kontratës për investime dhe kontratës për shkëmbimin e pasurive⁵¹;
- vi. të ardhura nga dëmshpërblimi në shumën 2,143,491 lekë sipas vendimit nr. ***, datë 31.7.1996, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. ***, datë 28.1.1997. Ekzekutimi i këtij vendimi vërtetohet me vërtetimin nr. *** prot., datë 17.12.2019, të cilit i është bashkëlidhur fleta e regjistrit të protokollit të ekzekutimit të vendimeve përmbarimore Durrës. Emri i babait ndodhet në nr. rendor ***;
- vii. të ardhura nga shitja e apartamentit me vlerë 2,000,000 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 17.9.2004.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, shpjegimet e dhëna prej tij pas dërgimit të barrës së provës në lidhje me burimin e ligjshëm të shumave prej 5,000,000 lekësh dhe 35,000 euro të trashëguar nga babai i tij I.H., vlerësoi se:

- i. Të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i shtetasës Xh.H. në vitet 1992 – 1994.
- ii. Të ardhurat e përfituara nga qiraja nga shtetasja Xh.H. në shumën 27,000 USD për periudhën 10.10.1994 – 9.10.1997, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.
- iii. Të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor ku shtetasja Xh.H. ka përfiturat shumat 9.729 USD dhe 6.300 USD, me një total të ardhurash 16,029 USD, janë marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara nga burime të ligjshme financiare.
- iv. Të ardhurat e përfituara nga shtetasja Xh.H. në shumën 400,000 lekë nga shitja e dyqanit të saj janë marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara nga burime të ligjshme financiare.
- v. Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive, dyqan me sip. 20 m² dhe apartament me sip. 60 m² të shtetasës Xh.H. – Komisioni ka marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara nga burime të ligjshme financiare vetëm ato të përfituara nga shitja e dyqanit.
- vi. Në lidhje me të ardhurat nga dëmshpërblimi në shumën 2,143,491 lekë sipas vendimit të gjykatave⁵², Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor përfitimin e dëmshpërblimit, duke vënë në dispozicion fletën e regjistrit të protokollit të ekzekutimit të vendimeve përmbarimore Durrës. Emri i shtetasit I.H. ndodhet në numrin rendor ***.
- vii. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në pronësi të shtetasit I.H., me vlerë 2,000,000 lekë sipas kontratës së shitblerjes datë 17.9.2004⁵³, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor përfitimin e kësaj shume, duke vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes datë 17.9.2004.

⁵¹ Me kontratën e shitblerjes së dyqanit datë 18.10.2011, shitësja Xh.H. ia shet blerësit B.B. dyqanin me sip. 20 m², shitur me çmimin 2,219,040 lekë i parapaguar cash jashtë kësaj zyre. Sipas kësaj kontrate çmimi i shitjes për m² është 110,952 lekë (2,219,040 lekë/20 m²).

Në lidhje me shitjen e apartamentin me sip. 60 m², siç e kam theksuar nuk e disponoj këtë kontrate dhe duke iu referuar çmimit të shitjes së dyqanit, çmimi i shitjes së apartamentit është 55,476 lekë/m², duke qenë se çmimi i apartamentit si rregull është dyfish më i ulët se çmimi i dyqanit dhe për rrjedhojë ka një të ardhur nga kjo shitje prej 3,328,560 lekësh (110,952 lekë/2 x 60 m²). Është e konfirmuar që të gjitha apartamentet dhe dyqanet e këtij pallati janë të shitura dhe te hipotekuara te blerësit.

⁵² Vendimi nr. ***, datë 31.7.1996, i Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. ***, datë 28.1.1997.

⁵³ Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 17.9.2004.

Komisioni ka analizuar ligjshmërinë e burimeve dhe mundësinë financiare për krijimin e shumave të trashëguara 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro, si më poshtë vijon:

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat Xh. + I.H.	6,152,781
1	Të ardhura nga aktiviteti tregtar i Xh.H., vitet 1992 - 1994	0
2	Të ardhura nga qiraja e dyqanit në periudhën 10.10.1994 - 9.10.1997, 750 USD/muaj, sipas kontratës nr. ***, datë 10.10.1994, në vlerën 27,000 USD	0
3	Të ardhura nga ekzekutimi i vendimet gjyqësore (I. H.) nr. ***, datë 18.3.1996, nr. ***, datë 31.7.1997, në vlerën 2,143,491 lekë	2,143,491
4	Të ardhura nga interesat, vitet 1997 - 1998	0
5	Të ardhura nga vendimet gjyqësore (Xh. H.) nr. ***, datë 22.9.1999, nr. ***, datë 20.4.2000, në vlerën 16,029 USD	1,609,290
6	Të ardhura nga shitja e dyqanit sipas kontratës nr. ***, datë 19.5.2001 (lidhet me pasurinë 1)	400,000
7	Të ardhura nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. ***, datë 17.9.2004 (lidhet me pasurinë 2)	2,000,000
B	Pasuri Xh. + I.H.	3,752,948
1	Blerë dyqan nga privatizimi sipas kontratës nr. ***, datë 3.6.1992 dhe mandatpagesës nr. ***, datë 30.3.1992	114,964
2	Blerë apartament sipas kontratës datë 25.2.2001	2,337,984
3	Dyqan me sip. 20 m ² sipas kontratës së shkëmbimit/sipërmarrjes nr. ***, datë 29.3.2003	0
4	Llogari dyemërore në ISPB në vlerën 1,300,000 me kontribut të z. I.H., viti 2008	1,300,000
	Depozitë datë 19.1.2009, znj. Xh.H., në vlerën 27,049 USD (kjo depozitë shërben si burim krijimi për shumën 22,883 euro të dhuruar)	2,542,065
C	Shpenzime Xh. + I.H.	2,306,118
1	Shpenzime jetike 1.1.1992 – 31.12.1996 (70% e të ardhurave - pagave)	0
2	Shpenzime jetike 1.1.1997 – 31.12.1999 (5,000 lekë/muaj për person)	360,000
3	Shpenzime jetike 1.1.2000 – 31.1.2009	1,946,118
	Mundësia financiare për kursime të kaluara me trashëgimi (A-B-C)	93,715
	Të ardhurat nga trashëgimia	9,800,950
	Shuma e dhuruar nga babai me trashëgimi më 12.2.2009 - 5,000,000 lekë	5,000,000
	Shuma e dhuruar nga babai me trashëgimi më 12.2.2009 - 25,000 euro <i>cash</i>	3,429,250
	Shuma e dhuruar nga babai me trashëgimi më 12.2.2009 - 10,000 euro (konfirmohet depozita 10,000 euro = 1,371,700 lekë)	1,371,700
	Të ardhura të trashëguara me burime jo të ligjshme	-9,707,235

Në përfundim të analizës për ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi për shumat 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro të trashëguar nga shtetasi I.H., subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm vetëm të shumës 93,715 lekë, ndërsa shuma prej 9,707,235 lekësh është e trashëguar nga babai i subjektit, e cila rezultoi e krijuar nga burime jo të ligjshme financiare.

11. Gjendja *cash* në banesë në shumat 10,000 euro dhe 100,000 lekë

Burimi i krijimit: nuk është përcaktuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, gjatë hetimit, ka kërkuar nga subjekti të përcaktojë burimin financiar të krijimit të gjendjes *cash*, si dhe dokumentacionin përkatës për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume. Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime edhe në lidhje me mospërputhjen e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2016 në shumën 1,700,000 lekë me atë të deklaruar në deklaratën “Vetting”, në shumat 10,000 euro dhe 100,000 lekë, të konvertuar në shumën 1,465,700 lekë).

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Të ardhurat janë jo vetëm ato që trashëgova, por dhe nga paga ime, e bashkëshortes, si dhe të fëmijëve, të cilat në mënyrë specifike i kam deklaruar duke depozituar dhe dokumentacionin përkatës.”*

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar mospërputhjen për gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me atë “Vetting”: *“Vlera 1,700,000 lekë ka qenë ekuivalente me 10,000 euro dhe 300,000 lekë. Nga shuma 300,000 lekë kam hapur llogari bankare në BKT ku kam depozituar shumën prej 200,000 lekësh në datën 26.1.2017. Kjo është bërë për shkak se sipas ligjit që u aprovua nuk lejohej mbajtja cash më shumë se 1.500.000 lekë”.*

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mospërputhjen e gjendjes *cash*.

Ndërsa, referuar burimit të krijimit nga trashëgimia, Komisioni vlerëson se shuma e trashëguar është krijuar me burime jo të ligjshme financiare.

12. Depozitë në BKT, dega Durrës, në llogarinë “blerje obligacione me afat 7-vjeçar”, e hapur në emër z. Edmond Hyka në datën 15.9.2014, në shumën 6,100,000 lekë

Burimi krijimi: kursimet e subjektit dhe të familjes.

Nga verifikimi i dokumenteve bankare rezulton se në datën 19.8.2014 nga llogaria bankare e Edmond Hyka në “Fibank” është transferuar shuma prej 6,100,000 lekësh në llogarinë e tij bankare në “BKT”.

Shuma prej 6,100,000 lekësh në “Fibank” është krijuar nga:

a) Shuma prej 4,500,000 lekësh e investuar në bono thesari në datën 30.9.2009, nga z. Edmond Hyka

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2009 subjekti deklaroi se shuma prej 4,500,000 lekësh ka si burim krijimi depozitën dyemërore të Edmond dhe I.H. në “Intesa Sanpaolo Bank”, llogari kjo me kontribut 100 % të subjektit, sipas deklarimit të tij në deklaratën periodike para fillimit të detyrës në vitin 2005 (3,000,000 lekë).

b) Depozita e hapur në datën 23.7.2012, në shumën 1,600,000 lekë nga z. Edmond Hyka në “Fibank”.

Shuma prej 1,600,000 lekësh ka si burim krijimi depozitën në “Alpha Bank” të krijuar në vitin 2009 me depozitim e shumës 1,300,000 lekë dhe të tërhequr *cash* më 1.6.2012, në shumën 1,378,300 lekë.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2008 subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2009 subjekti ka deklaruar: “Te Alpha Bank shuma e depozituar e deklaruar dhe më parë 1,300,000 lekë”.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2010 subjekti nuk ka deklaruar.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011 subjekti ka deklaruar: “Si është deklaruar më parë te ‘Alpha Bank’ Durrës kam të depozituar shumën prej 1,300,000 lekësh (ka qenë depozitë me babanë)”.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “Sipas deklaramit të mëparshëm në ‘Alpha Bank’ kam pas depozituar shumën prej 1,300,000 lekësh, që së bashku me fitimet prej 59,025 lekësh i kam transferuar në FIBank duke shtuar depozitën me kursimet e mia në 1,600,000 lekë dhe fituar 100,000 lekë interes.”

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të specifikojë sa nga shuma 6,100,000 lekë janë kursimet e tij dhe sa janë kursime të familjes.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “Shuma 6,100,000 ka ardhur nga mbyllja e investimeve në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, në vlerë 4,500,000 lekë, të cilat mbas mbylljes janë kaluar si depozitë kursimi te “Fibank”, duke ju bashkuar depozitës së mëparshme me vlerë 1,600,000 lekë pranë kësaj banke.

Komisioni ka kërkuar shpjegime në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të shumave 4,500,000 lekë dhe 1,600,000 lekë, që kanë shërbyer si burim krijimi për investimin në obligacione në shumën 6,100,000 lekë.

Subjekti ka sqaruar se: “Kjo shumë është si kontribut i punës time si avokat dhe e deklaruar që në fillim të punës në detyrën e prokurorit në vitin 2005, kjo shumë është rritur si pasojë e interesave bankare të depozituara ndër vite dhe të deklaruara me rregullsi për çdo vit. Me kursimet familjare është nënkuptuar përdorimi me kujdes dhe ekonomi i të ardhurave totale të përfituara nga paga ime dhe e gruas. Këto fonde vijnë thjesht nga mbledhja dhe përqendrimi i depozitave apo investimeve në bono thesari dhe kapitalizimi i interesave të fituara, të cilat janë deklaruar edhe në vitet e mëparshme.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kontributi i tij në llogarinë dyemërore me babanë, të çelur në datën 27.9.2005, në shumën 3,000,000 është 75 - 80 % (burim krijimi i shumës 4,500,000 lekë).

Në lidhje me llogarinë dyemërore në “Alpha Bank” në shumën 1,300,000 lekë, që ka shërbyer si burim krijimi për depozitën në “Fibank” në shumën 1,600,000 lekë subjekti ka deklaruar se: “Kjo depozitë është hapur nga babai im dhe unë nuk kam qenë në dijeni. Në momentin e marrjes dijeni për faktin lartpërmendur, bëra deklaramin në periudhën përkatëse.”

Subjekti nuk ka dhënë shpjegim në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës prej 1,300,000 lekësh.

Komisioni ka analizuar në tabelën e mëposhtme mundësinë financiare të subjektit për krijimin e shumës prej 3,000,000 lekësh, referuar burimit të deklaruar prej tij.

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	2,215,303
1	Mundësia për kursime e mbetur më 1.1.2003 (pas blerjes së pasurive në vitin 2002)	545,308
2	Të ardhura nga aktiviteti si avokat në vitet 2003 - 2004	780,000
3	Të ardhura nga pagat bashkëshortja, vitet 2003 - 2004 - 8.2005	889,995
B	Pasuri	2,282,024
1	Blerë automjeti, viti 2003	1,547,763
2	Depozitë në RBAL në emër të z. Edmond Hyka	734,261

C	Shpenzime	2,671,196
1	Shpenzime jetike, vitet 2003 - 2004 - 8.2005	1,043,064
2	Shpenzime mobilimi, vitet 2003 - 2004	1,400,000
3	Shpenzime udhëtimi, viti 2004	228,132
	Mundësia për kursime më 30.8.2005, që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë dyemërore hapur në 27.9.2005 (A-B-C)	-2,737,917

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime në lidhje me mospërputhjet e burimit të krijimit të depozitave dyemërore në shumave 3,000,000 lekë (burimi i krijimit të depozitës 4,500,000 lekë) dhe 1,300,000 lekë (burimi i krijimit të depozitës 1,600,000 lekë) dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të këtyre depozitave.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, në përgjigje të tij ka shpjeguar se: *“... sipas konstatimit të relacionit nuk justifikohet burimi fillestar i depozitës 3,000,000 lekë në momentin e fillimit të detyrës, në tabelën e mëposhtme paraqitet teprica e kursimeve për periudhën 2000 – 2005 dhe justifikojnë plotësisht burimin e ligjshëm të krijimit”*.

Këtë deklaram subjekti e ka paraqitur në mënyrë tabelare (ku përfshihen të ardhurat, detyrimet, shpenzimet dhe pasuritë e krijuara deri në vitin 2005) dhe sipas pretendimit të tij rezulton me balancë pozitive në shumën 112,929 lekë.

Subjekti, në lidhje me pasaktësitë në deklaram, ka shpjeguar se: *“...në lidhje me pasaktësitë e deklaramit mbi burimin e vlerave nga babai, apo prindërit dhe nga kursimet e mia, ju theksoj se: babai ishte në gjendje për të kryer aktivitetet, ndaj ka realizuar të ardhura dhe të gjitha të ardhurat totale (përfshirë edhe të miat) janë administruar nga babai im. Për rrjedhojë është e pamundur që të përcaktohet saktësisht burimi i krijimit të të ardhurave dhe kursimeve nga prindërit, apo nga aktiviteti im, apo nga shitja e pronave të prindërve”*.

Në lidhje me mosdeklarimin e llogarisë dyemërore prej 1,300,000 lekësh në “Alpha Bank” në vitin 2008, subjekti ka shpjeguar: *“...deklarimi i saj është bërë në momentin e konstatimit. Gjithsesi këto vlera janë deklaruar gjendje cash në deklaratën e vitit përkatës 2008”*.

Subjekti ka bashkëlidhur dhe një aktekspertimi financiar të përgatitur nga një ekspert kontabël privat.

Gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore ka deklaruar që mund të ndodhë që një llogari bankare të hapet në favor të një personi të tretë dhe personi i tretë nuk është në dijeni. Llogaria është hapur nga babai i tij dhe subjekti nuk ka pasur asnjë lloj dijenie.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se:

- Subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me burimin e krijimit të depozitës 3,000,000 lekë, pasi deklarimet e tij janë kontradiktore për sa i përket burimit të krijimit⁵⁴.

⁵⁴ Në përgjigje të pyetësorëve subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga avokatia dhe kursimet familjare, duke nënkuptuar përdorimin me kujdes dhe ekonomi të të ardhurave totale të përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Në prapësimet e tij subjekti ka deklaruar si burim krijimi, përveç të ardhurave nga avokatia, edhe kursimet familjare, të ardhurat nga aktiviteti privat i nënës dhe kursimet e prindërve.

- b) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës dyemërore në shumën 3,000,000 lekë. Burimi i krijimit i deklaruar nga subjekti gjatë hetimit rezultoi i pamjaftueshëm për të krijuar depozitën dyemërore në vitin 2005, pasi ky burim është përdorur në krijimin e pasurive të vitit 2002 (apartament banimi dhe dyqan), si dhe për këtë burim subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, pasi ka deklaruar vlera të ndryshme⁵⁵.
- c) Subjekti nuk ka deklaruar depozitën dyemërore në emër të tij dhe të babait në shumën 1,300,000 lekë, në deklaratën e pasurisë të vitit 2008, por e deklaroi atë në vitin 2009.
- d) Pavarësisht se subjekti, për depozitën dyemërore në shumën 1,300,000 lekë nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mospërputhjen për burimin e krijimit⁵⁶, nga analiza financiare Komisioni vlerësoi se kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e ligjshme të babait të subjektit⁵⁷.

13. Depozitë në “BKT” e hapur në emër z. Edmond Hyka në datën 26.1.2017, në shumën 200,000 lekë, me burim krijimi: kursime familjare

Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit si burim krijimi për hapjen e depozitës zvogëlimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës

Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar⁵⁸.

14. Të ardhura të përfituara nga z. Edmond Hyka nga depozita në bono thesari në shumën 1,200,236 lekë dhe nga depozita në obligacione në shumën 1,007,187 lekë

Subjekti ka investuar në obligacione dhe bono thesari nga të cilat ka krijuar të ardhura në formën e interesave.

Shuma prej 1,200,236 lekësh është përfituar si e ardhur nga interesat për investimin në bono thesari të shumës 4,500,000 lekë, për periudhën 2009 – 2012 në FIBank⁵⁹. Burim i krijimit të investimit në bono thesari sipas deklaramit të subjektit është depozita në llogarinë dyemërore në “Intesa Sanpaolo Bank”, e hapur në datën 27.9.2005, në shumën 3,000,000 lekë dhe e mbyllur në datën 30.9.2009.

Shuma prej 1,007,187 lekësh është përfituar si e ardhur nga interesat për investimin në obligacione 7-vjeçare të shumës 6,100,000 lekë, për periudhën 2015 – 2016 në BKT⁶⁰. Burim i krijimit të investimit në obligacione në shumën 6,100,000 lekë është shuma prej 4,500,000 lekësh e investuar në bono thesari në datën 30.9.2009 nga z. Edmond Hyka dhe depozita e hapur në datën 23.7.2012 në shumën 1,600,000 lekë nga z. Edmond Hyka në FIBank.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të depozitave prej të cilave janë gjeneruar të ardhura nga interesat në shumën 1,200,236 lekë dhe në shumën 1,007,187 lekë dhe subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “Të

⁵⁵ Subjekti në deklaratën “Vetting” pretendon të ardhura nga avokatia në vlerën 10,000,000 lekë, ndërsa në prapësime pretendon të ardhura nga avokatia në vlerë bruto 8,875,500 lekë, ose në vlerë neto 7,100,000 lekë. Në të njëjtin dokument, në një paragraf tjetër, subjekti pretendon të ardhura nga avokatia në shumën 8,520,480 lekë.

⁵⁶ Në pyetësor subjekti deklaroi se depozita është hapur nga babai, ndërsa në deklaratën “Vetting” deklaroi si burim krijimi për shumën 4,500,000 lekë dhe 1,600,000 lekë kursimet e tij dhe të familjes.

⁵⁷ Për referencë tabela në faqen nr. 38.

⁵⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2019, e BKT-së.

⁵⁹ Shkresa nr. ***, datë 24.9.2019, e Fibank.

⁶⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2019, e BKT-së.

ardhura të përfituara nga depozita në bono thesari në shumën 1,200,236 lekë dhe nga depozita në obligacione në shumën 1,007,187 lekë vijnë nga kursimet në depozitën dyemërore me afat pranë 'Intesa Sanpaolo Bank' hapur në vitin 2005 me vlerë 3,000,000 lekë dhe nga kursimet në depozitën emërore me afat pranë 'Alpha Bank' me vlerë 1,300,000 lekë.”

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të depozitës dyemërore në shumën 3,000,000 lekë, e cila ka shërbyer si burim krijimi për investimin në bono thesari në shumën 4,500,000 lekë, nga ku është përfitur në formën e interesave shuma 1,200,236 lekë.

Për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo depozitë në shumën 1,200,236 lekë janë të ardhura jo të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës: “... subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave”, të cilat nuk janë përfshirë në analizën financiare nga Komisioni.

- b) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës prej 4,500,000⁶¹ lekësh, e cila ka shërbyer si burim për investimin në obligacione 7-vjeçare në shumën 6,100,000 lekë, nga ku janë krijuar të ardhurat nga interesat në shumën 1,007,187 lekë. Pjesa e të ardhurave të interesave që i përket shumës 4,500,000 lekë është 743,006 lekë dhe si rezultat janë të ardhura jo të ligjshme, për rrjedhojë këto të ardhura nuk janë marrë në analizë nga Komisioni.

15. Depozitë në BKT, dega Durrës, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. E.H., në shumën 20,000 euro

Burim i krijimit: kursimet familjare dhe të prindërve.

Nga verifikimi i dokumenteve bankare rezulton se në datën 17.7.2012 bashkëshortja e subjektit ka depozituar *cash* në llogarinë në “BKT” shumën 20,000 euro. Kjo shumë është mbajtur në bankë e investuar në formën e depozitës. Në datën 10.4.2019, me maturimin e depozitës, shuma prej 18,500 euro i është kaluar shtetasit G.H..

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të saktësojë se sa nga shuma 20,000 euro është krijuar nga të ardhurat e prindërve dhe sa nga kursimet e familjes, duke i dokumentuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “*Shuma 20,000 euro është shumë e trashëguar nga babai im (nga vlera 35,000 euro) dhe jo nga prindërit e bashkëshortes dhe është e mbartur gjendje cash që nga viti 2009. Kjo gjendje cash është pasqyruar edhe në deklaratën e pasurisë të vitit 2009 e në vazhdim, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 12.3.2010*”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

⁶¹ Investimi në shumën 6,100,000 lekë përbehet nga shumat 4,500,000 lekë dhe 1,600,000 lekë. Shuma prej 4,500,000 lekësh përbën 74 % të investimit të shumës 6,100,000 lekë, ndërkohë që pjesa e mbetur prej 26 % i përket shumës 1,600,000 lekë. Si rrjedhojë, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në analizë 74 % të shumës prej 1,007,187 lekësh (që është 743,006 lekë), pasi janë të ardhura jo të ligjshme. Ndërkohë që pjesa e mbetur e shumës 1,007,187 lekë (që është 264,181 lekë) është e ardhur e ligjshme, pasi është gjeneruar nga depozita prej 1,600,000 lekësh me burim llogarinë dyemërore të babit të subjektit në shumën 1,300,000 lekë, për të cilën Komisioni konkludoi se është krijuar me të ardhura të ligjshme.

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime në lidhje me mospërputhjet e burimit të krijimit të depozitës dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të kësaj depozite, i cili, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Depozita bankare pranë BKT, me datë 17.7.2012, dhe vlerë të depozituar 20,000 euro, e ka burimin nga kursimet e trashëguara nga babai në vitin 2009, dhe burimi i ligjshëm i tyre është argumentuar në çështjen e llogarive bankare më lart.”*

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, arrin në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës në shumën 20,000 euro (analizuar në pikën 10 të vendimit).
- b) Rezultojnë mospërputhje në lidhje me burimin e krijimit të depozitës prej 20,000 euro, pasi në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi të saj kursimet e familjes dhe të prindërve, ndërsa gjatë hetimit deklaroi si burim krijimi kursimet e trashëguara nga babai.

16. Depozitë në “BKT” në obligacione me afat 2-vjeçar, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. E.H., në shumën 4,500,000 lekë

Burim i krijimit: dhurim nga prindërit dhe kursime familjare.

Nga verifikimi i dokumenteve bankare rezulton se në datën 17.3.2015 në llogarinë bankare në BKT është transferuar shuma prej 4,500,000 lekësh për investim në obligacione 2-vjeçare.

Si burim krijimi për shumën 4,500,000 lekë ka shërbyer shuma 3,500,000 lekë, e depozituar *cash* në datën 24.2.2010 (kjo shumë ka qëndruar e depozituar në bankë dhe e investuar herë në bono thesari dhe herë në depozita) dhe shuma prej 730,312 lekësh, e transferuar në datën 5.3.2012 nga shtetasja Xh.H. në favor të znj. E.H.

Si burim për shumën 3,500,000 lekë, të depozituar më 24.2.2010, ka shërbyer shuma 2,000,000 lekë e depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank” në shkurt të vitit 2007, e krijuar nga tërheqja e depozitave në BKT nga llogaritë dyemërore me shtetasen B.Sh. (e ëma e E.H.) dhe shtesës prej 1,500,000 lekësh në vitin 2009 me të ardhurat e trashëguara nga babai i subjektit.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të specifikojë se sa nga shuma 4,500,000 lekë janë dhurim nga prindërit e bashkëshortes dhe sa janë të ardhura nga kursimet e familjes.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Të ardhura nga dhurimi i prindërve janë në vlerën 2,000,000 lekë, dhe 1,500,000 lekë nga trashëgimia e lënë nga babai dhe 730,312 lekë të kaluara nga llogaria e nënës time me transfertë bankare tek “BKT”, diferenca vjen nga rikapitalizimi i interesave dhe kursimet familjare.”*

Për shumën prej 2,000,000 lekësh të dhuruar nga nëna e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion si dokumentacion provues ligjor deklaratën noteriale të datës 25.5.2005⁶², ku prindërit e bashkëshortes deklarojnë të kenë marrë shumën 7,000,000 lekë për një shitje apartamenti, të përfituar nga një kontratë sipërmarrjeje të investuar në pronën e tyre.

Nga verifikimi i veprimeve bankare ka rezultuar se znj. E.H. vetëm një ditë pas deklaratës noteriale ka depozituar në datën 26.5.2005 në llogarinë dyemërore me nënën e saj në “BKT” shumat 20,000

⁶² Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.5.2005, lëshuar nga prindërit e znj. E.H.

USD dhe 3,000,000 lekë. Këto shuma janë tërhequr nga banka në datën 5.6.2006 nga shtetasja B.Sh.

Në deklaratën pasurore për vitin 2006 subjekti ka deklaruar se bashkëshortja E.H. ka tërhequr shumën e depozituar bashkë me të ëmën dhe pjesën e saj prej 2,000,000 lekësh e ka depozituar në janar të vitit 2007 në “Bankën Amerikane”.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të specifikojë sa nga shumat prej 20,000 USD dhe 3,000,000 lekë janë kontribut i bashkëshortes.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “Këto shuma janë vetëm me kontribut të prindërve të bashkëshortes”.

Për shumën prej 1,500,000 lekësh subjekti i rivlerësimit ka sjellë si dokumentacion provues deklaratën noteriale të datës 12.3.2010 për shumën 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro të trashëguar nga babai.

Për shumën prej 730,312 lekësh konfirmohet veprimi bankar i transferimit në datën 5.3.2012 nga llogaria bankare e znj. Xh.H. në llogarinë bankare të znj. E.H.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës:

- a) për të dhënë shpjegime në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve për burimin e krijimit të shumave 2,000,000 lekë dhe 4,500,000 lekë;
- b) për të provuar me dokumentacion provues ligjor shumat e dhuruara 2,000,000 lekë, 1,500,000 lekë dhe 730,312 lekë, që kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 4,500,000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, nuk ka shpjeguar mospërputhjet e konstatuara nga Komisioni, por ka dhënë shpjegime vetëm për sa i përket burimit të krijimit të shumave të dhuruara⁶³.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni, që ka të bëjë me burimin e krijimit të shumës 2,000,000 lekë.

⁶³ Dhurim i prindërve të bashkëshortes nga të ardhurat e krijuara nga zhvillimi dhe shitja e investimit në pronën e tyre. Nga kjo kontratë investimi në vitin 2005 është përfituar vlera 7,000,000 lekë. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës është bërë deklarimi për depozitë dyemërore në emër të bashkëshortes dhe nënës së saj prej 5,000,000 lekësh dhe është nënkuptuar depozita me vlerë 20,000 USD me kursin 1 USD = 100 lekë dhe depozita me vlerë 3,000,000 lekë. Nga këto depozita bashkëshortja ka përfituar vlerën 2,000,000 lekë dhe ky përfitim është deklaruar në vitin 2006, ku është vënë edhe shënimi që është depozituar në bankë në janar të vitit 2007.

Si përfundim, bashkëshortja ka përfituar nga prindërit e saj vetëm vlerën 2,000,000 lekë. Bashkëngjitur deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.12.2019, të lëshuar nga nëna e bashkëshortes B.Sh., e cila konfirmon dhurimin e vlerës 2,000,000 lekë. Vlera 1,500,000 lekë e lënë trashëgimi nga babai i z. Edmond Hyka në vitin 2009, nga shuma prej 5,000,000 lekësh e deklaruar *cash*, e cila është rikonfirmuar nga nëna Xh.H., si dhe motrat D.C. dhe T.M. me deklaratën noteriale të vitit 2010. Burimi i ligjshëm i kësaj vlere është argumentuar në çështjen e llogarive bankare të sipërcituara. Vlera e dhuruar nga nëna e z. Edmond Hyka me transfertë bankare prej 730,312 lekësh, burimi i së cilës është argumentuar në çështjen e burimit të vlerës prej 32,000 euro, dhuruar djalit G.H.

- b) Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mospërputhjen e konstatuar në lidhje me burimin e krijimit të shumës 4,500,000 lekë.
- c) Subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion provues ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 2,000,000 lekë, të përfituar nga dhurimi i nënës së bashkëshortes⁶⁴.
- d) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 1,500,000 lekë, me burim trashëgiminë e babait në shumat 5,000,000 lekë dhe 35,000 euro. Komisioni ka analizuar në pikën nr. 10 të vendimit ligjshmërinë e shumës së trashëguar nga babai i subjektit dhe arriti në konkluzionin se shuma 1,500,000 lekë është krijuar nga burime jo të ligjshme.
- e) Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me shumën e dhuruar 730,312 lekë. Komisioni vlerësoi se shuma prej 730,312 lekësh e ka burimin nga të ardhurat nga shitja e dyqanit me sip. 20 m² në shumën 2,219,040 lekë, për të cilën subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues kontratën e shitjes.⁶⁵

Mundësia financiare për dhurimin e shumës 730,312 lekë nga znj. Xh.H. për znj. E.H. është e pasqyruar në tabelën, si vijon:

	Përshkrim	Vlera në lekë
A	Të ardhurat	2,219,040
1	Mundësia për kursime të mbetura në vitin 2009 pas trashëgimisë	0
2	Të ardhura nga shitja e dyqanit me sip. 20 m ² sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.10.2011 (lidhen me kontratën e sipërmarrjes/shkëmbimit) 2,219,040 lekë	2,219,040
B	Shpenzime	550,884
1	Shpenzime jetike, periudha 1.1.2009 – 31.12.2012	550,884
	Mundësia financiare për kursime të dhuruara në shumën 730,312 lekë (A-B)	1,668,156

17. Llogari rrjedhëse në “BKT” në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. E.H., me gjendje në datën 29.12.2016, në shumën 55,339 lekë

Burim krijimi: të ardhurat familjare dhe pagesa e qirasë.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqës

Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar në “BKT”⁶⁶.

18. Të ardhura të bashkëshortes së subjektit, znj. E.H., të përfituara nga depozitat në bono thesari, në obligacione dhe depozita bankare në shumën 1,635,649 lekë

Bashkëshortja e subjektit ka investuar në obligacione dhe bono thesari nga të cilat ka krijuar të ardhura në formën e interesave.

⁶⁴ Si dokumentacion provues ligjor subjekti ka depozituar: deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.5.2005, me deklaruës shtetasit B. dhe S.Sh., të cilët deklarojnë se i kanë shitur shtetasit N.Sh. apartamentin në pronësi të tyre në vlerën 7,000,000 lekë, ndërkohë që shtetasi N.Sh. konfirmon kryerjen e këtij transaksioni; deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.12.2019, të lëshuar nga nëna e bashkëshortes B.Sh., në të cilën deklarohet përfitimi i shumës 7,000,000 lekë nga shitja e apartamentit, shumë nga e cila është depozituar në bankë në llogari të saj dhe të vajzës E.H. vlera prej 5,000,000 lekë. Me tërheqjen e kësaj shume nga banka deklaroi se i ka dhuruar vajzës vlerën 2,000,000 lekë.

⁶⁵ Kontrata e shitjes nr. ***, datë 18.10.2011, me blerëse B.B.

⁶⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2019, e BKT-së.

Shuma prej 1,635,649 lekësh është e ardhur e përfituar nga akumulimi i interesave:

- a) për periudhën 2010 - 2011, i investimit herë në depozitë dhe herë në bono thesari në “BKT” i shumës prej 3,500,000 lekësh (shuma 3,500,000 lekë është krijuar nga shuma 2,000,000 lekë dhuruar nga nëna e bashkëshortes në vitin 2007 dhe 1,500,000 lekë trashëguar bashkëshortit nga babai në vitin 2009). Shuma e interesave për këtë periudhë është 279,238 lekë.
- b) për periudhën 2012 - 2016 i investimit në depozitë dhe obligacione 2-vjeçare në “BKT” të shumës 4,500,000 lekë (burim për shumën 4,500,000 lekë ka shërbyer shuma 3,500,000 lekë e investuar nga bashkëshortja për periudhën 2010 - 2012 dhe shuma 730,312 lekë dhuruar nga nëna e bashkëshortit më 5.3.2012). Shuma e interesave për këtë periudhë është 1,356,425 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të depozitave prej të cilave janë gjeneruar të ardhura nga interesat në shumën 1,635,649 lekë.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se: *“Të ardhurat e bashkëshortes E.H. të përfituara nga depozitat në bono thesari, në obligacione dhe depozita bankare në shumën 1,635,649 lekë janë nga burimet e ligjshme, ligjshmëria e të cilave është argumentuar në pikën e mësipërme të llogarive bankare të E.H.”.*

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimet e krijimit të shumës 3,500,000 lekë nga ku është përfituar për periudhën 2010 - 2011 në formën e interesave shuma 279,238 lekë:
 - i. provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 2,000,000 lekë – për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë janë të ardhura të ligjshme dhe janë marrë në analizë nga Komisioni.
 - ii. nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 1,500,000 lekë – për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë⁶⁷ në shumën 119,674 lekë janë të ardhura jo të ligjshme, kjo në kuptim të pikës 3 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye këto të ardhura nuk janë marrë në analizë nga Komisioni.
- b) Subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimet e krijimit të shumës 4,500,000 lekë nga ku është përfituar për periudhën 2012 - 2016 në formën e interesave shuma 1,356,425 lekë:
 - i. provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 2,000,000 lekë – për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë janë të ardhura të ligjshme dhe janë marrë në analizë nga Komisioni.
 - ii. nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 1,500,000 lekë – për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë⁶⁸ në shumën 452,142

⁶⁷ Investimi në shumën 3,500,000 lekë përbëhet nga shumat 2,000,000 lekë dhe 1,500,000 lekë. Shuma prej 2,000,000 lekësh përbën 57 % të investimit të shumës 3,500,000 lekë, ndërkohë që pjesa e mbetur prej 43 % i përket shumës 1,500,000 lekë. Si rrjedhojë, Komisioni ka marrë në konsideratë në analizë 57 % të shumës 279,238 lekë (që është 159,565 lekë) pasi janë të ardhura të ligjshme. Ndërkohë që pjesa e mbetur e shumës 279,238 lekë (që është 119,674 lekë) është e ardhur jo e ligjshme pasi është gjeneruar nga shuma prej 1,500,000 lekësh me burim trashëgiminë nga babai i subjektit për të cilën Komisioni konkludoi se është krijuar me të ardhura jo të ligjshme.

⁶⁸ Investimi në shumën 4,500,000 lekë përbëhet nga shuma 2,000,000 lekë, 1,500,000 lekë dhe 730,312 lekë. Shuma prej 2,000,000 lekësh përbën 44 % të investimit të shumës 4,500,000 lekë, shuma 1,500,000 lekë përbën 33% të shumës 4,500,000 lekë, ndërsa shuma 730,312 lekë përbën 16 % të kësaj shume. Si rrjedhojë, Komisioni nuk ka marrë

- lekë janë të ardhura jo të ligjshme, kjo në kuptim të pikës 3, të nenit “D”, të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye këto të ardhura nuk janë marrë në analizë nga Komisioni.
- iii. provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 730,312 lekë – për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë janë të ardhura të ligjshme dhe janë marrë në analizë nga Komisioni.

19. Llogari rrjedhëse në “BKT” në emër të shtetasit G.H., me gjendje deri në datën 27.1.2017, në shumën 36 euro

Burim krijimi: pagesa e qirasë.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar në “BKT”⁶⁹.

20. Depozitë në “Fibank” në emër të vajzës së subjektit, I.H., në shumën 17,000 euro

Burim krijimi: kursimet e subjektit dhe të familjes dhe përfitimet nga depozita.

Në datën 15.11.2016 konstatohet se është transferuar nga llogaria e shtetasit Edmond Hyka shuma prej 17,616.18 euro në llogarinë e znj. I.H.

Shuma e transferuar nga shtetasi Edmond Hyka ka si burim krijimi shumat e depozituara *cash* në FIBank më 9.10.2009, përkatësisht 11,000 euro në llogarinë dyemërore të Edmond dhe I.H. dhe 3,000 euro në llogarinë e Edmond Hyka, me të ardhurat e trashëguara nga shtetasi I.H., të deklaruara edhe në deklaratën pasurore të vitit 2009.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të kësaj depozite.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Burimi i ligjshëm i shumës 17,000 euro është argumentuar në çështjen e llogarive bankare dhe vjen nga gjendja cash prej 35,000 euro, e trashëguar nga babai pas vdekjes në vitin 2009 dhe deklarimi është bërë po në këtë vit.”*

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit, nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës në shumën 17,000 euro. Komisioni ka analizuar në pikën nr. 10 të vendimit ligjshmërinë e shumës së trashëguar nga babai i subjektit dhe arriti në konkluzionin se shuma 17,000 euro është krijuar nga burime jo të ligjshme.

KONSTATIME TË TJERA

në konsideratë në analizë 33 % të shumës 1,356,425 lekë (që është 452,142 lekë) pasi janë të ardhura jo të ligjshme. Ndërkohë që ka marrë në analizë të ardhurat nga interesat për pjesët 44 % dhe 16 % e shumës 4,500,000 lekë.

⁶⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2019, e BKT-së.

Kontratë shitblerje e datës 17.9.2004⁷⁰ me shitës z. I.H. dhe blerës K. dhe L.B. për apartamentin me sip. 81.2 m², në vlerën 2,000,000 lekë me adresë: Rr. “****”, Lagjja ***, p. ***, z.k. ***, Durrës.

Kontratë huaje vlerash monetare e datës 17.9.2004⁷¹, me huadhënës z. Edmond Hyka dhe huamarrës K. dhe L.B. për dhënien hua të shumës 1,300,000 lekë për një

afat kohor të kthimit të saj, pjesërisht ose tërësisht, brenda datës 30.4.2005. Subjekti Edmond Hyka ka deklaruar se këtë hua ua jep shtetasve pa ndonjë përqindje interesi. Në këtë deklaratë, pala huamarrëse deklaron se do ta kthejë huan, pjesërisht ose tërësisht, brenda datës 30.4.2005.

Në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit në vlerën 2,000,000 lekë nga shtetasi I.H., babai i subjektit, Komisioni ka krahasuar çmimin e shitjes me çmimin e referuar nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB), për vitin 2004⁷² dhe ka rezultuar se çmimi i blerjes së referuar në kontratë është dyfish më i ulët sesa çmimi referues i EKB-së.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë situatën e shitjes së apartamentit nga babai, në vitin 2004, blerësve K. dhe L.B., në shumën 2,000,000 lekë dhe dhënien hua nga subjekti dy shtetasve të lartpërmendur po të njëjtën ditë në shumën 1,300,000 lekë, pa përqindje interesi dhe, nëse ka njohje të mëparshme me dy shtetasit dhe nëse ia kanë kthyer huan apo jo.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “Unë, shtetasit K. dhe L.B. i kam njohur kur ata do të blinin apartamentin e babait tim I.H. Për shkak se ata nuk plotësonin shumën 10,000 euro dhe do të iknin, pasi ishin refugjatë në Itali dhe babai im nuk pranonte të firmoste dokumentet pa e plotësuar edhe këtë shumë, bëmë marrëveshje që unë u kisha dhënë atyre huan prej 10,000 euro, të cilën ata e kanë kthyer brenda afatit kohor, të caktuar në kontratë dhe mbaj mend që për shumën e marrë i kam lëshuar edhe një deklaratë personale, kunatit të tij, në mos gaboj (vëllait të gruas, kështu më është paraqitur), i cili ishte personi që solli shumën e lekëve. Me këta persona nuk kam asnjë lloj lidhje që nga dita e firmosjes së kontratës dhe nuk e di se ku ndodhen aktualisht. Këta shtetas e kanë kthyer brenda afatit kohor të caktuar në kontratë dhe mbaj mend që për shumën e marrë i kam lëshuar edhe një deklaratë personale, kunatit të tij, në mos gaboj (vëllait të gruas, kështu më është paraqitur), i cili ishte personi që solli shumën e lekëve”.

Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë me shtetasit K. dhe L.B. Për këtë qëllim, Komisioni ka kryer korrespondencë me Prokurorinë e Apelit Durrës dhe Prokurorinë e Apelit Tiranë⁷³.

Prokuroria e Apelit Durrës ka konfirmuar se pranë Gjykatës së Apelit Durrës nuk rezulton të jetë regjistruar asnjë çështje penale në ngarkim të shtetasve K. dhe L.B.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

⁷⁰ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 17.9.2004, për apartamentin me sip. 81.2 m², me shitës z. I.H. dhe blerësit K. dhe L.B.

⁷¹ Kontrata e huas nr. ***, datë 17.9.2004, me huadhënës z. Edmond Hyka dhe huamarrës shtetasit K. dhe L.B.

⁷² Udhëzimit nr. ***, datë 4.3.2004, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja dhe të koeficientit ‘K’ për vitin 2004”. EKB-ja ka përcaktuar se nga të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në Durrës, çmimi i apartamenteve përllogaritet me vlerën 52,792 lekë/m² dhe për apartamentin konkret është 81.2 m² x 52,792 lekë/m² = 4,286,671 lekë. Rezulton se subjekti, apartamentin e lartpërmendur, e ka shitur me një çmim dyfish më të ulët sesa çmimi referues i EKB-së, që llogaritet në vlerën 4,580,343 lekë, sipas udhëzimit të EKB-së.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.12.2019, e Prokurorisë së Apelit Durrës.

Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës nga Komisioni, për të dhënë shpjegime në lidhje me caktimin e një çmimi fiktiv nga babai në kontratën e shitjes, si dhe mungesën e dokumentacionit referuar huas së kthyer nga shtetasit K. dhe L.B.

Subjekti, në lidhje me diferencën e çmimit të shitjes, ka shpjeguar se: *“Edhe nëse ky apartament është shitur me një vlerë më të lartë sesa deklarimi në kontratë, ky fakt është në disfavorin tim”*.

Subjekti, në lidhje me kontratën e huadhënies së datës 17.9.2004, ka dhënë të njëjtat shpjegime si më lart, në lidhje me njohjen dhe arsyen e dhënies së huas dy blerësve, ndërkohë që në lidhje me dokumentacionin provues që shuma e huas është kthyer, subjekti ka deklaruar: *“...këta shtetas e kanë kthyer brenda afatit kohor të caktuar në kontratë dhe mbaj mend që për shumën e marrë i kam lëshuar deklaratë personale kumatit të tij, i cili ishte personi që më solli lekët. Nëse unë do kisha pretendime se ata nuk e kanë shlyer detyrimin do ta kisha kërkuar në rrugë gjyqësore. Për më tepër, kjo pasuri është rishitur përsëri nga blerësit...”*.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar prej tij, arrin në konkluzionin se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit nga babai, z. I.H., dhe në analizën financiare është marrë në konsideratë vlera 2,000,000 lekë, e pasqyruar në kontratë.

Në lidhje me automjetet e subjektit të rivlerësimit

- **Automjeti tip “Mercedes-Benz E 220 CDI”, viti i prodhimit 2006, me targa ***, blerë në datën 19.5.2011, në shumën 8500 euro dhe shitur datë 15.11.2011, në shumën 10,000 euro.**

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Kam ndërruar automjete dhe përkatësisht kam shitur dhe blerë tri automjete, të cilat ia kam blerë shtetasit A.G. dhe shitur shtetasve F.K. dhe V.L. (me banim në Durrës) dhe A.O. me banim në Tiranë...”*

DPSHTRR-ja⁷⁴ ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, ku rezulton se automjeti tip “Mercedes-Benz E 220 CDI” i vitit 2006 ka qenë në pronësi të shoqërisë “R.T. Automobile” në Gjermani dhe në datën 12.5.2011 blihet nga shtetasi A.G. për çmimin 6800 euro. Dokumenti doganor i datës 18.5.2011 tregon se për këtë automjet është paguar taksa doganore në vlerën 359,178 lekë ose 2500 euro (llogaritur çmimi 6800 euro, me kursin ditor 1 euro =142,40 lekë) nga shtetasi A.G. Me kontratën e shitjes së datës 19.5.2011⁷⁵, z. A.G. ia shet automjetin tip “Mercedes-Benz 220 CDI”, viti i prodhimit 2006, me targa ***, subjektit Edmond Hyka me vlerën 8500 euro. Subjekti Edmond Hyka me kontratën e shitblerjes së datës 15.11.2011⁷⁶ ia shet automjetin shtetasit V.L., me vlerën 10,000 euro, paguar në gjendje *cash*.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë se përse në deklaratën e pasurisë së vitit 2011 ka deklaruar shitblerjen e tri automjeteve dhe nuk ka përcaktuar vlerat e blerjes dhe shitjes së tyre.

Subjekti, në përgjigje të tyre, ka shpjeguar se: *“Unë nuk i pata shënuar këto specifikime dhe për këtë jam thirrur dhe kam bërë specifikimet e nevojshme në ILDKPKI.”*

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë arsyen e blerjes dhe shitjes së këtyre automjeteve me vlera të konsiderueshme në periudha kohore, brenda vitit 2011.

⁷⁴Shkresë me nr. *** prot., datë 24.9.2019, e DPSHTRR-së.

⁷⁵Kontrata e shitjes së automjetit nr. ***, datë 19.5.2011, me shitës z. A.G. dhe blerës z. Edmond Hyka.

⁷⁶Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 15.11.2011.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Blerjen dhe shitjen e automjetit në një periudhë të shkurtër kohore e kam bërë pasi nga shitja e automjetit përfitoja një shumë prej 1,000 euro.”*

- **Automjeti tip “Mercedes-Benz 220 CDI 203”, viti i prodhimit 2001, me targa ***, blerë në datën 27.4.2009, në shumën 970,000 lekë dhe shitur datë 29.8.2011, në shumën 8000 euro.**

Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” të vitit 2001.

Subjekti, në deklaratën periodike të vitit 2011, ka deklaruar: *“Kam ndërruar automjete dhe përkatësisht kam shitur dhe blerë 3 automjete, të cilat ia kam blerë shtetasit A.G. dhe shitur shtetasve F.K. dhe V.L. (me banim në Durrës) dhe A.O. me banim në Tiranë.”*

Me kontratën e shitjes së datës 29.8.2011⁷⁷, subjekti Edmond Hyka, ia ka shitur shtetasit F.K. me çmimin 8000 euro, likuiduar në gjendje *cash*.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të japë shpjegime se përse në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009 nuk është deklaruar blerja e këtij automjeti.

Subjekti, në përgjigje të tij, shpjegon se: *“Nuk e kam shënuar në deklaratë shitjen e automjetit dhe blerjen e automjetit tjetër për neglizhencë, duke menduar se këto veprime janë të dokumentuara dhe lehtësisht të verifikueshme. Për këtë jam thirrur dhe kam dhënë shpjegime specifike në ILDKPKI, duke paraqitur dhe dokumentacionin që më kërkuan. Bashkëngjitur janë kontratat”.*

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së datës 27.4.2009, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator z. A.G. dhe blerës z. Edmond Hyka për automjetin tip “Mercedes-Benz”, viti 2003, me targa (vendi bosh), për shumën 970,000 lekë.

- **Automjeti tip “Mercedes-Benz 220 CDI 202”, viti i prodhimit 1998, me targa ***, blerë në datën 19.12.2003, në shumën 8000 euro dhe shitur datë 18.9.2009, në shumën 920,000 lekë.**

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *“Një automjet tip ‘Benz-Mercedes’, viti 1998, me vlerë 8000 euro, pjesë takuese 100 %, burim krijimi nga të ardhurat si avokat në vitet 1998 – 2005, si dhe me të ardhura të babait tim nga disa prona dhe vit krijimi 2003.”*

Në deklaratën e vitit 2009 subjekti nuk ka deklaruar shitjen e këtij automjeti.

Ky automjet është blerë në datën 19.12.2003, në Itali, nga z. Edmond Hyka me çmimin 8000 euro, duke paguar dhe taksën doganore në vlerën 478,563 lekë (kursi i euros 135.31 lekë).

Me kontratën e shitjes së datës 18.9.2009⁷⁸, z. Edmond Hyka, ia shet automjetin shtetasit Z.P., me çmimin 920,000 lekë, likuiduar në gjendje *cash*.

Komisioni ka konstatuar se shitja e këtij automjeti nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2009 dhe për këtë qëllim i ka kërkuar të japë shpjegime.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Nuk e kam shënuar në deklaratë shitjen e automjetit dhe blerjen e automjetit tjetër për neglizhencë, duke menduar se këto veprime janë të dokumentuara dhe lehtësisht të verifikueshme”.*

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

⁷⁷Kontrata e shitjes së automjetit nr. ***, datë 19.5.2011, me shitës z. A.G. dhe blerës z. Edmond Hyka.

⁷⁸Kontrata e shitjes së automjetit nr. ***, datë 18.9.2009, me shitës z. Edmond Hyka dhe blerës z. Z.P.

- Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të japë shpjegime në lidhje me:
- mosdeklarimin e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjeteve, në deklaratën periodike të vitit 2011;
 - mosdeklarimin e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2001, me targa ***, në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009;
 - mosdeklarimin e shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1998, me targa ***, në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009;

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: *“Nuk kam shënuar në deklaratë vlerën e shitjes dhe blerjes së automjeteve për neglizhencë, duke menduar se këto veprime janë të dokumentuara dhe lehtësisht të verifikueshme. Për këtë jam thirrur dhe kam dhënë shpjegime specifike në ILDKPKI, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar”*.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, arrin në konkluzionin se subjekti nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e shitjes dhe blerjes së automjeteve në vitin 2009, si dhe mosdeklarimin e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjeteve, në deklaratën periodike të vitit 2011.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme, nuk ka bërë deklarime të sakta të pasurisë, sipas parashikimeve në pikën 5, të nenit “D”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁷⁹, si dhe nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.⁸⁰

Në lidhje me shpenzimet e jetesës së fëmijëve, qira etj., gjatë kohës së studimeve

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me shpenzimet e udhëtimit apo qiratë për fëmijët, I. dhe G.H., gjatë kohës së studimeve apo dhe të punësimit në Tiranë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: *“Të dy fëmijët e mi, I. dhe G.H., gjatë vazhdimit të studimeve kanë bërë lëvizjet me mua vajtje - ardhje Durrës-Tiranë dhe nuk kanë paguar shpenzime për qira banese.”*

Nga korrespondenca me Ministrinë e Drejtësisë⁸¹ është konstatuar një veprim noterial i kryer nga vajza e subjektit, I.H., pranë noteres I.Sh.⁸², në datën 12.4.2013.

Noterja I.Sh. ka përcjellë në Komision dokumentin që është përpiluar në zyrë e saj, në datën 12.4.2013, dhe konstatohet se dokumenti në fjalë është kontratë qiraje e datës 12.4.2013⁸³, me qiradhënës shtetasit R.D. dhe E.Z. dhe qiramarrës znj. I.H., për marrjen me qira të një apartamenti me sip. 100 m², me adresë: Rr. “****”, me afat 1-vjeçar për periudhën 15.4.2013 – 14.4.2014, me të drejtë rinovimi, me qira mujore në vlerën 34,000 lekë/muaj.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

⁷⁹Neni “D” i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Vlerësimi i pasurisë”, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit të kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

⁸⁰Neni 33 i ligjit nr. 84/2016, pika 5/b, “deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.....”.

⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2019, nga Ministria e Drejtësisë.

⁸²Notere I.Sh. me shkresën e datës 19.11.2019.

⁸³Kontrata e qirasë nr. ***, datë 12.4.2013.

Komisioni, me kalimin e barrës së provës, kërkoi nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e marrëdhënies së qirasë të lidhur nga vajza, kur subjekti është pyetur në lidhje me qëndrimin e fëmijëve gjatë kohës së shkollimit dhe punësimit në Tiranë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “... kontrata e qirasë nuk është përmbushur nga palët, pasi fillimisht, vajza, I.H., bashkë me tri shoqe të tjera studente do ta merrnin apartamentin por, së pari, qiradhënësit e revokuan kontratën pasi iu kthyen fëmijët e tyre, dhe së dyti, dy nga shoqet u tërhoqën dhe kostot e qirasë ishin të papërbalueshme.”

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës dhe deklaratën noteriale të datës 16.12.2019⁸⁴, me deklaruese znj. E.V., e cila deklaroi se kontrata e qirasë e lidhur në datën 12.4.2013, bashkë me znj. I.H., nuk u përmbush dhe nuk u ekzekutua për dhënie me qira dhe se u larguan me mirëkuptim nga qiradhënësi.

❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, i konsideroi të mjaftueshme, pa ndonjë problematikë në lidhje me këtë konstatim.

Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhënat e deklaramëve periodike vjetore në ILDKPKI, deklaratën “Vetting”, informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse dhe deklaramet e subjektit. Z. Edmond Hyka ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2005.

1.1 Metodologjia e kryerjes së analizës financiare. Për efekt të pasqyrimit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare, është bazuar në: deklaramet e interesave pasurore private/vjetore; deklaratën “Vetting”; pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

1.2 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar, vitet 2005 – 2016, bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe honoraret në vlerë *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten⁸⁵, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës

1.3 Për të ardhurat nga aktiviteti⁸⁶ janë marrë në analizë vlerat sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, drejtuar ILDKPKI-së për qarkullimin faktik për periudhën 2000 – 2005, pa vitin 2003.

1.4 Për të ardhurat në formën e interesave bankare të depozitave/obligacioneve/bonove të thesarit janë marrë në analizë vlerat sipas nxjerrjes së llogarive bankare, për të ardhurat e gjeneruara

⁸⁴Deklarata noteriale nr. ***, datë 16.12.2019, me deklaruese znj. E.V.

⁸⁵Vërtetim datë 26.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës.

⁸⁶Shkresa me nr. *** prot., datë 11.7.2017, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

nga depozitat/obligacionet/bonot e thesarit, për të cilat është provuar me dokumentacion provues ligjor burimi i krijimit të tyre.

1.5 Për të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme (automjete) janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave të shitblerjeve.

1.6 Për të ardhurat në formën e dhurimit⁸⁷ nuk janë marrë në analizë vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratat e interesave pasurore, pasi duket se ka mungesë dokumentacioni provues ligjor për burimin e krijimit të tyre.

1.7 Për të ardhurat nga qiraja janë marrë në konsideratë vlerat për të cilat ka pasur kontratë dhe për të cilat është vërtetuar pagesa e tatimit.

1.8 Për të ardhurat nga dëmshpërblimet janë marrë në konsideratë vlerat sipas vendimeve gjyqësore, për të cilat është vërtetuar marrja e dëmshpërblimit.

1.9 Lidhur me shpenzimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën “Vetting”, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

1.10 Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë, si më poshtë:

- shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën e ILDKPKI-së, me nr. *** prot., datë 4.3.2019, drejtuar Komisionit. Për vitin 2007, konsumi për frymë është marrë sa shpenzimi i llogaritur për vitin 2006, në vlerën 136,620 lekë.

Për periudhën 2005 – 2016, shpenzimet jetike janë llogaritur për familje me 4 anëtarë;

- shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht, lëvizjet hyrje – dalje, nëpërmjet sistemit *TIMS*, të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit. Për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë deklaratimet e subjektit mbi kostot e shpenzuara për secilin udhëtim, vendimi nr. 11/2019(JR), datë 22.5.2019 i Komisionit të Posaçëm të Apelit, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit;

- shpenzimet e mobilimit janë marrë në analizë, referuar deklaratimit të subjektit në pyetësin nr.1 për shumën totale prej 1,400,000 lekësh, të detajuar sipas viteve kur janë kryer, referuar deklarimeve të subjektit. Në procesverbalin e qershorit të vitit 2016, subjekti ka deklaruar se shpenzimet e mobilimit janë kryer në vitin 2005;

- shpenzimet e shkollimit janë marrë në analizë, referuar deklaratimit të subjektit në pyetësin nr.1, vërtetimit të lëshuar nga institucionet⁸⁸, si dhe sipas dokumentacionit financiar të pagesave;

- shpenzimet e udhëtimit Tiranë-Durrës janë marrë në analizë, referuar deklaratimit të subjektit në pyetësin nr. 2;

- **shpenzimet e qirasë së vajzës** nuk janë marrë në analizë, referuar deklaratimit të subjektit.

⁸⁷Deklarata noteriale nr. ***, datë 12.3.2010.

⁸⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 20.12.2018, nga Universiteti Polis se për periudhën 2009 – 2014, znj. I.H., ka paguar vlerën 22,500 euro; vërtetim datë 22.11.2018, nga Albanian University se për periudhën 2012 – 2017, z. G.H., ka paguar vlerën 23,500 euro.

- 1.11 Lidhur me pasuritë e krijuara dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën “Vetting”, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.
- 1.12 Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore. Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* të akumuluar, përputhen me gjendjen e kursimeve *cash*, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”.
- 1.13 Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve.
- 1.14 Likuiditetet (*cash*, bankë), janë regjistruar në një nënkategori të pasurisë “kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)”. Në këtë kategori kemi pasqyruar ndryshimin e zërit likuiditete, pra, shtesën ose pakësimin e ndodhur gjatë vitit përkatës në likuiditete.
- 1.15 Lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të krijuara për periudhën 2005 – 2016, janë marrë në konsideratë vlerat e tyre referuar kontratave të shitblerjes.
- 1.16 Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës “Vetting” për periudhën e hetimit, pra, 2005 – 2016, të kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera prej tij dhe personave të lidhur me të, duke rezultuar me një balancë financiare negative në shumën 18,851,028 lekë, në vitet 2005, 2007, 2009 dhe 2011 – 2014.

Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar me dokumentacion provues ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve, krijimin e kursimeve dhe pasurisë së deklaruar prej tij dhe personit të lidhur me të, për periudhën 2005 – 2016.

Në përfundim, nga analiza financiare e rishikuar për periudhën 2003 – 2016, pas vlerësimeve që iu bënë nga trupi i gjykimit shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 11,614,353 lekë, si më poshtë:

Përshkrimi	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	3,417,198	1,391,778	1,566,482	1,506,960	3,150,247	1,871,530	2,831,932	6,115,273	2,451,864	2,643,519	3,298,325	3,450,938
Të ardhura të trashëguara nga kontributi në llogaritë dy emërore	-	-	-	-	93,715	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të trashëguara në 12.02.2009 5,000,000 lekë + 35,000 Euro	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga dhurimi i B.Sh	2,000,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga dhurimi nga gjyshja për G.H.	-	-	-	-	-	-	-	3,197,213	-	-	-	-
Të ardhura nga dhurimi nga gjyshja për E.H	-	-	-	-	-	-	-	730,312	-	-	-	-
Të ardhura nga paga	697,629	1,086,889	1,091,170	1,130,984	1,167,342	1,145,440	1,265,171	1,174,986	1,152,160	1,238,195	1,249,130	1,278,505
Të ardhura nga aktiviteti	300,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	403,247	297,061	351,723	375,976	456,688	485,461	516,446	534,490	551,560	585,654	582,358	533,512
Të ardhura nga paga djali	-	-	-	-	-	-	-	297,000	472,800	472,800	472,800	472,800
Të ardhura nga paga vajza	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	498,000	695,238
Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga qiraja	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	132,144	229,959
Të ardhura nga interesat	16,322	7,828	123,589	-	898,464	717,647	428,623	579,963	478,329	490,159	896,432	605,752
Saktësim i interesave të krijuara me burime jo të ligjshme	-	-	-	-	385,962	477,019	348,308	398,691	202,985	143,288	532,539	364,828
Të ardhura nga shitja e pasurive	-	-	-	-	920,000	-	970,000	-	-	-	-	-
Detyrime	0	0	0	1,300,000	0	0	0	0	0	0	0	0
Kontribut nga babai në llogarinë 2 emërore 3,000,000 lekë	-	-	-	1,300,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Kontribut nga babai në llogarinë 2 emërore 1,300,000 lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime	438,228	462,226	720,847	760,940	1,294,428	1,392,196	1,314,166	1,414,811	1,665,273	2,533,867	2,334,339	1,806,669
Shpenzime jetike	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	0	23,998	144,367	184,460	100,683	191,071	115,336	52,255	159,812	12,610	143,156	227,586
Shpenzime mobilimi	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	375,600	-
Shpenzime shkollimi I.H	0	0	0	0	617,265	624,645	622,350	628,740	350,525	280,220	0	0
Shpenzime shkollimi G.H	0	0	0	0	0	0	0	139,720	560,840	1,331,045	619,425	608,715
Shpenzim tatim në burim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzim për kalimin e të drejtës së pronësisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	269,054	-
Shpenzime qiraje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime udhëtimi Tiranë - Durrës	-	-	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
Pasuri	5,731,510	566,752	1,332,506	373,312	10,092,733	183,803	1,635,197	4,324,372	312,927	130,250	-140,473	-125,680
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	5,731,510	566,752	1,332,506	373,312	9,122,733	183,803	224,537	4,324,372	312,927	130,250	4,638,073	125,680
Apartament 121 m2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dyqan në plazh 52.5 m2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banesë private me sip.truall 308.5 m2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Banesë në emër të G.H me sip.65.5 m2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,497,600	-
Automjet Benz tip E 280 CDI në emer të E.H dhe G.H (****)	-	-	-	-	-	-	1,410,660	-	-	-	-	-
Autoveturë Tip Benz V.1998 C 220 CDI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë Tip Benz E 220 CDI (****)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë Tip Benz 203 C 220 CDI (****)	-	-	-	-	970,000	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	-2,752,540	362,800	-486,871	1,672,709	-8,236,914	295,531	-117,430	376,089	473,663	-20,597	1,104,460	1,769,949

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera prej tij dhe personat e lidhur, ndër vite.

Subjekti ka pasaktësi dhe mospërputhje në deklaratime, si dhe deklaratim të pamjaftueshëm të pasurisë, ndër vite.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 5.12.2019, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond I. Hyka, i deklasifikuar plotësisht (raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017, dërguar në Komision) dhe nga grupi i punës është konkluduar se:

“Për subjektin e rivlerësimit, z. Edmond I. Hyka, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Për sa më sipër, grupi i punës, konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Rivlerësimi profesional sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 5.7.2019, për subjektin Edmond Hyka.

Në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë evidentuar aftësi të mira të subjektit të rivlerësimit në lidhje me:

- ✓ Aftësitë profesionale ku përfshihen: njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor.
- ✓ Aftësitë organizative ku përfshihet: aftësia për të përballuar ngarkesën në punë; aftësia për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar dosjet.
- ✓ Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale ku përfshihen: etika në punë; integriteti dhe paanësia.

- ✓ Aftësitë personale dhe angazhimi profesional ku përfshihen: aftësitë e komunikimit; aftësia për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për t'u angazhuar.

Komisioni ka shqyrtuar 3 (tri) dokumentet e paraqitur nga subjekti, referuar raportit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

- **Dokumenti ligjor “konkluzione” për vendimin penal nr. ***, datë 7.3.2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë⁸⁹.**

Me dokumentin “konkluzione përfundimtare” prokurori Edmond Hyka ka kërkuar: lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 7.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 11.1.2014, ka vendosur cilësimin e veprës penale për të pandehurit, duke ulur dhe dënimin përkatës.

Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë është paraqitur rekurs nga prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti Edmond Hyka, dhe me vendimin nr. ***, datë 29.4.2015, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit penal nr. ***, datë 11.1.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në atë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se dokumenti i paraqitur nga subjekti Edmond Hyka, paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika.

- **Dokumenti ligjor “konkluzione” për vendimin penal nr. ***, datë 19.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

Vendimi i gjykatës është dhënë në ngarkim të të pandehurit F. Xh. i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Organi i akuzës ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të pandehurin R. Xh., për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal; F.P. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim; G.F. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim.

Me vendimin nr. ***, datë 18.7.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

Të pandehurit R. Xh. dhe G. Q. janë deklaruar fajtorë për akuzat e ngritura nga prokuroria dhe janë dënuar sipas marzheve të dënimit të përcaktuara në Kodin Penal, ndërsa për të pandehurin F.Q., gjykata e ka deklaruar të pafajshëm. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur konkluzionet përfundimtare dhe në cilësinë e prokurorit të Apelit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 19.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur: deklarimin fajtor të të pandehurit F. Q., për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim” dhe dënimin e tij me tetë vjet.

⁸⁹Subjekti i rivlerësimit ka përpiluar konkluzionet përfundimtare për vendimin penal nr. ***, datë 7.3.2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Me këtë vendim gjykata ka deklaruar fajtor secilin nga të pandehurit I. P. dhe E. P., për veprat penale: “vrasje me dashje” dhe “plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar në nenet 76 dhe 88 të Kodit Penal. Kundër këtij vendimi, brenda afatit ligjor kanë bërë ankim tre të pandehurit I. P., E. P. dhe E. P.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 26.9.2012, ka vendosur: Mospranimin e ankimit të bërë nga prokuroria.

Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 20.5.2015 ka vendosur: prishjen e vendimit nr. ***, datë 26.9.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër gjykues.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se dokumenti i paraqitur nga subjekti Edmond Hyka paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika.

➤ Dokumenti ligjor “konkluzione” për vendimin penal nr. *, datë 14.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Organi i akuzës në konkluzionet përfundimtare ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit E. D., të akuzuar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera të cilësuar”, e mbetur në tentativë parashikuar në germën “ë”, të nenit 79 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 vjet burg dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim. Dënimi i të pandehurit me 18 vjet burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin penal nr. ***, datë 14.11.2011, ka vendosur ndryshimin e cilësimit të veprës penale dhe dënimin e të pandehurit me një masë më të butë të dënimit.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokurori i seancës, i cili kërkon ndryshimin e vendimit për sa i përket cilësimit juridik. Konkretisht, ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga “kanosja” në veprën penale “vrasje në rrethana cilësuese”, e mbetur në tentativë dhe dënimin e të pandehurit sipas kërkesës në konkluzione përfundimtare.

Në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Edmond Hyka, ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 14.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur: deklarinimin fajtor të të pandehurit E.D. për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera”, të cilësuar mbetur në tentativë dhe dënimin me 18 vjet burgim; deklarinimin fajtor të të pandehurit E.D. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim. Dënimi i të pandehurit me 18 vjet burgim.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se dokumenti i paraqitur nga subjekti Edmond Hyka paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika.

Komisioni ka shqyrtuar pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, referuar raportit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

1. Dosja gjyqësore penale për vendimin nr. ***, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. ***, datë 7.10.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë me të pandehur A.V., i akuzuar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

Prokuroria e Shkallës së Parë, në përfundim të hetimeve, ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të pandehurin A.V., për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. I pandehuri A.V. i kërkoi gjykatës procedimin me formën e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar të gjitha aktet e hetimit paraprak. Kjo kërkesë e të pandehurit u pranua nga gjykata.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2014 ka vendosur: deklarin fajtor të të pandehurit A.V. për kryerjen e veprës penale “vjedhje” dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406, të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 1 vit e 4 muaj burgim, duke mbështetur dhe qëndrimin e mbajtur nga organi i akuzës.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri A.V., i cili kërkoi ndryshimin e vendimit për masën e dënimit, duke kërkuar një vendim më të butë.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, Prokuroria e Apelit Tiranë është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, i cili ka përpiluar aktin “konkluzione” për këtë vendim penal nr. ***, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.10.2015 ka vendosur lënien në fuqi, të vendimit penal nr. ***, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se dokumenti “konkluzione” i paraqitur nga subjekti Edmond Hyka paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika.

- 2. Dosja gjyqësore penale për vendimin nr. ***, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë me të pandehurit K. T., J. P. dhe E. M. i akuzuar secili për kryerjen e veprës penale “vjedhje në bashkëpunim”, i parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të hetimeve, ka dërguar çështjen për gjykim ndaj të pandehurve K.T., J.P. dhe E.M. për kryerjen e veprës penale “vjedhje” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal dhe dënimin e secilit me 6 muaj burgim dhe në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale uljen me 1/3 e dënimit të tyre.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 8.10.2014, ka vendosur: deklarin fajtor të të pandehurve K.T. dhe E.M. për veprën penale “vjedhje” e kryer në bashkëpunim dhe dënimin e saj me 6 muaj burgim, në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove prej 18 muajsh dhe deklarin e pafajshëm të të pandehurës J.P. për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, të kryer në bashkëpunim, për shkak se nuk provohet që e pandehura të ketë kryer veprën për të cilën akuzohet.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nuk është dakord me vendimin e gjykatës për deklarin e pafajshëm të të pandehurës J. P. për kryerjen e veprës penale të vjedhjes. Prokurori ka pretenduar se Gjykata e Shkallës së Parë nuk i ka vlerësuar drejt provat.

Subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka përgatitur dokumentin “konkluzione”, datë 23.3.2015 dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar: ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me të pandehurën J.P., duke kërkuar deklarin fajtore të

shtetases J.P. për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 9 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke dënuar përfundimisht të pandehurën J.P. me 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59, të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e të dënuarës J.P. për një periudhë kohe prej 18 muajsh.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Subjekti Edmond Hyka ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afatit të parashikuar në ligj. Ky dokument shfaq qëndrimin e prokurorit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se dokumenti i paraqitur nga subjekti Edmond Hyka paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika.

3. Dosja gjyqësore penale për vendimin nr. *, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe vendimin nr. ***, datë 25.9.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë të dënuarit G.G. dhe P.V.**

Kërkuesit G. G. dhe P. V. (8 vite pasi ishte dhënë vendimi i dënimit ndaj tyre) i janë drejtuar gjykatës me një kërkesë për rivendosje në afat, i së drejtës së ankimit me pretendimin se mbrojtësit e caktuar prej tyre nuk kanë ushtruar ankim ndaj vendimit të dënimit të tyre.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 30.9.2010, ka vendosur: pranimin e kërkesës së të dënuarve G.G. dhe P.V. dhe rivendosjen në afat të drejtës së të dënuarve për të bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë kundër vendimit nr. ***, datë 9.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Kundër këtij vendimi, prokurori, ka paraqitur ankim duke parashtruar shkaqet ligjore.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.2.2011, ka vendosur: ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 30.9.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesve G.G. dhe P.V. për rivendosjen në afat të ankimit, si të pabazuar në ligj.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit kanë ushtruar rekurs të dënuarit G.G dhe P.V, të cilët kërkojnë prishjen e vendimit të mësipërm.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 5.9.2012, ka vendosur: prishjen e vendimit nr. ***, datë 4.2.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Pas kthimit të çështjes për rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 15.3.2013 vendosi: prishjen e vendimit nr. ***, datë 30.9.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me trup gjykues tjetër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 31.1.2013 ka vendosur: rrëzimin e kërkesës së të dënuarve G.G. dhe P.V. për rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. ***, datë 9.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Kundër këtij vendimi, në datën 6.11.2013, kanë bërë ankim kërkuesit G.G. dhe P.V. duke kërkuar: prishjen e vendimit penal nr. ***, datë 31.1.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe pranimin e kërkesës për rivendosje në afat.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Edmond Hyka, ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me dokumentin “konkluzione” ka kërkuar: lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 30.9.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2014, ka vendosur: rivendosjen në afat të kërkuesve G.G. dhe P.V. për të ushtruar ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 9.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Subjekti Edmond Hyka ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 25.9.2014.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se dokumenti i paraqitur nga subjekti Edmond Hyka paraqitet i standardizuar në aspektin formal dhe procedural dhe nuk konstatohen problematika.

4. Dosja gjyqësore penale për vendimin nr. *, datë 29.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe atë të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë me person nën hetim E.K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të vlerësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të personit nën hetim E.K. dhe caktimin ndaj tij si masë sigurimi personal “arrest në burg”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 29.9.2016, ka vendosur: vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim E.K. dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim E.K., atë të arrestit në burg.

Personi nën hetim E.K. ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi dhe ka kërkuar caktimin e një mase dënimi më të butë.

Me ndjekjen e çështjes në Gjykatën e Apelit është ngarkuar prokurori Edmond Hyka.

Bazuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 14.11.2008, “Për ushtrimin me eficiencë të së drejtës së ankimit”, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar dokumentin “informacion”, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit z. D.P. Në këtë dokument, subjekti shpreh qëndrimin se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet të ndryshohet për masën e sigurimit personal, duke caktuar ndaj personit të dyshuar E.K., masën e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit, subjekti Edmond Hyka ka paraqitur “konkluzionet” ku ka kërkuar: ndryshimin e vendimit penal nr. akti ***, datë 29.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë *për masën e sigurimit personal duke caktuar ndaj personit të dyshuar E.K., masën e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.*

Subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, në ndryshim nga prokurori dhe Gjykata e Shkallës së Parë, mban qëndrimin se në rastin konkret duhet të caktohet masa e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur”.

Në aktin “konkluzione” shihet e argumentuar rrezikshmëria e veprës penale dhe rrezikshmëria e ulët e autorit, duke marrë në konsideratë edhe sasinë e lëndës narkotike të sekuestruar, pendimin e thellë, vazhdimin e proceseve edukuese, i padënuar më parë, rrethanën që është

përdorues i lëndëve narkotike etj. Dokumenti “konkluzione” është sigluar dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.10.2016, ka vendosur: miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë lidhur me vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë ndaj personit në hetim E.K.; ndryshimin e vendimit lidhur me masën e sigurimit personal ndaj personit nën hetim E.K., duke caktuar si masë “detyrim paraqitje” etj.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, me kalimin e barrës së provës, i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me qëndrimin e mbajtur ndryshe nga qëndrimi i prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me masën e sigurimit personal të personit nën hetim nga “arrest në burg” me “detyrim paraqitje”.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Ndryshimin e masës së sigurimit për personin nën hetim E.K., e kam bërë duke respektuar normat procedurale, për caktimin e masës së sigurimit, të parashikuara nga nenet 22, 8, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale.*

Nga aktet e dosjes rezultonte se nuk ndodhemi përpara kryerjes së veprës penale ‘prodhimi dhe shitja e narkotikëve’ në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal.

Nisur nga praktika gjyqësore, kur sasia e lëndës narkotike është konsideruar e vogël, si në rastin konkret në sasinë 6.6 gram, të faktit se personi nën hetim E.K., që në fillim ka pretenduar se është përdorues i lëndës narkotike, nuk ka pasur asnjë të dhënë policore për implikimin e këtij personi në aktivitet tjetër të kundërligjshëm.

Gjithashtu, referuar dhe faktit se lënda ishte blerë për përdorim vetjak, faktit që nuk ishte i dënuar më parë, si dhe vazhdonte studimet e larta në vitin e tretë të Universitetit Bujqësor Kamëz dhe do t’i ndërpritej edukimi dhe shkollimi i tij, mbështetur në kriteret e neneve 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale kam kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit personal në atë të ‘detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

*Për këtë qëndrim, që do të mbaja në bazë të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 14.11.2008, kam informuar Drejtuesin e Prokurorisë, i cili e ka gjetur të bazuar në prova dhe në ligj qëndrimin tim.”*

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, e ka mbështetur qëndrimin në respektim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe më konkretisht, në nenet 228, 229 dhe 230. Pika 3⁹⁰, e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar rastet se kur aplikohen këto masa sigurimi personal, duke i analizuar me rrethanat konkrete të çështjes në fjalë. Në këtë këndvështrim, subjekti i rivlerësimit, në kërkesën e bërë përpara Gjykatës së Apelit Tiranë, ka argumentuar se ndryshimi i masës së sigurimit nga “arrest me burg” në “detyrim për paraqitje” është kërkuar duke marrë parasysh rrethanat se nuk është rasti i veprës penale “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, personi i pandehur nuk ka pasur precedentë të mëparshëm penal, sasia e lëndës narkotike është e asaj sasive që përdoret

⁹⁰Pika 3, neni 228 i Kodit të Procedurës Penale masat e sigurimit personal vendosen kur: (a) ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; (b) i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; (c) për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit, ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

për përdorim vetjak, rrezikshmëria e pakët, si dhe ndërprerja e edukimit të vazhdueshëm e këtij personi si frekuentues i një universiteti.

Këto argumente të dhëna nga subjekti Edmond Hyka, në seancën e Gjykatës së Apelit, janë mbështetur nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë ndaj personit nën hetim E.K. dhe ndryshimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” me “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me konstatimin e bërë.

5. Dosja gjyqësore penale e vendimit nr. *, datë 2.7.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. ***, datë 27.11.2013, e Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë të të pandehurit A.K. me objekt “kundërshtim i vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2012”**

Prokuroria e Rrethit Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***. Kallëzuesja A.K. nuk ka qenë dakord me vendimin e mosfillimit, marrë nga Prokuroria e Tiranës dhe e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 2.7.2013 vendosi: pranimin e kërkesës së A.K. dhe anulimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, që i përket kallëzimit penal nr. ***, vitit 2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve dhe urdhëron kryerjen e një akti ekspertimi nga një grup ekspertësh.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokurori i seancës në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës. Prokurori Edmond Hyka, në dokumentin ligjor “konkluzione”, ka kërkuar: ndryshimin e vendimit penal nr. *** akti, datë 2.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës së A.K., si të pambështetur në prova dhe ligj.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 27.11.2013, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 2.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se “organi i akuzës duhet të kryejë një akt ekspertimi autoteknik me grup ekspertësh, si dhe është konsideruar mangësi e hetimit mosmarrja në pyetje nga prokurori i të dëmtuarës nga aksidenti automobilistik. Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrimin se: “Kundër këtij vendimi nuk do të ushtroj rekurs, pasi gjykata ka lënë veprime konkrete për t’u kryer”.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni, me kalimin e barrës së provës, kërkoi nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me qëndrimin e subjektit që ka mbështetur qëndrimin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur ndryshe nga ky qëndrim dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se ka mbështetur qëndrimin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pavarësisht qëndrimit të dy gjykatave, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, duke dhënë argumentet përkatës, si dhe duke

iu referuar bindjes juridike të tij⁹¹. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar edhe arsyen e mosushtrimit të rekursit prej tij për në Gjykatën e Lartë, pasi do t'i shërbente vetëm praktikës gjyqësore, por nuk do të ndërpriste veprimet e caktuara nga Gjykata e Apelit dhe për këtë, subjekti ka informuar dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Apelit.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimin e bërë duke mos konstatuar ndonjë problematikë.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

Nga verifikimi i të dhënave në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë rezulton se nuk ka pasur masa disiplinore ndaj subjektit. Nuk ka të dhëna që për subjektin Edmond Hyka të ketë të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së tij në kontakte të papërshtatshme.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka, janë depozituar katër denoncime nga publiku.

1. Denoncim i shtetasit V.Ç. me nr. *** prot., datë 9.10.2018 ngre ankesa për shumë subjekte rivlerësimi, duke përfshirë dhe subjektin Edmond Hyka, si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, por nuk jepen të dhëna apo prova konkrete për përfshirje të subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Nga Komisioni nuk vërehen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

2. Denoncim i shtetasit V.Ç. me nr. *** prot., datë 11.7.2019 ngre ankesa për shumë subjekte rivlerësimi, duke përfshirë dhe subjektin Edmond Hyka. Ky denoncim është përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Ankuesi V.Ç. ngre të njëjtat ankesa për korrupsion, falsifikim etj., për të gjitha subjektet e përmendura në denoncim.

⁹¹“Në këtë material kallëzues është administruar dhe akti i ekspertimit autoteknik, i cili ka përcaktuar se shkak i ndodhjes së aksidentit janë shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorës, shtetases A.K., e konkretisht të nenit 188/5, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, ndërsa nga drejtuesi i automjetit, z. A.V., nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazë të këtij fakti ka vendosur ‘Mosfillimin e procedimit penal’ lidhur me materialin kallëzues nr. ***, për shkak se mungojnë elementet e veprës penale. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga e dëmtuara, znj. A.K., dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** akti, datë 2.7.2013 vendosi: pranimin e kërkesës së znj. A.K. dhe anulimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, që i përket kallëzimit penal nr. ***, vitit 2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve dhe urdhëron kryerjen e një akti ekspertimi nga një grup ekspertësh. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim prokurori i çështjes duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës. Unë me bindje juridike, e kam përkrahur këtë qëndrim, duke argumentuar se në rastin konkret, nuk ka indicie që akti i ekspertimit autoteknik ka mangësi. Ky qëndrim është miratuar edhe nga drejtuesi i prokurorisë së Apelit. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi me vendimin nr. ***, datë 27.11.2013, lënien në fuqi të vendimit nr. ***akti, datë 2.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Unë, pas këtij vendimi, kam informuar drejtuesin e prokurorisë, se nuk do të ushtroj rekurs ndaj vendimit, kjo së pari, pasi ushtrimi i rekursit vetëm do të shërbente për praktikë gjyqësore, pasi nuk do të ndërpriste urdhërimin për kryerjen e detyrave të lëna nga Gjykata. Së dyti, nisur nga fakti se edhe Gjykata e Apelit e konsideroi se në rastin konkret duhet kryer një akt ekspertimi dhe ushtrimi i të drejtës së rekursit nuk e pezullonte këtë vendim, parashtrova se nuk do ta ushtroja këtë të drejtë. Ky qëndrim përsëri është konsideruar i drejtë nga drejtuesi i prokurorisë”.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Nga Komisioni nuk vërehen problematika që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me vlerësimin profesional.

3. Denoncim i shtetasit B.M. me nr. ***, datë 17.10.2019 ngre ankesa për subjektin Edmond Hyka, pasi ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nga masa e sigurimit “arrest me burg”, në masën e sigurimit “arrest në shtëpi” me argumentin se kjo masë nuk është e përshtatshme dhe jo në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesi, rezulton se prokurori i Gjykatës së Apelit, z. Edmond Hyka, nuk ka mbështetur qëndrimin e prokurorit të Shkallës së Parë, si dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, që kanë caktuar si masë sigurimi “arrest me burg” për shtetasin F. Ll.

Prokurori Edmond Hyka në Gjykatën e Apelit ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe dhënien e një mase më të butë për të pandehurin në atë të “arrest shtëpie”, pasi sipas tij i pandehuri ka një rrezikshmëri të ulët shoqërore duke u bazuar në një deklaratë noteriale, që e lehtëson pozitën e të pandehurit në këtë proces. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 26.9.2019, ka vendosur: ndryshimin e vendimit nr. ***akti, datë 10.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke caktuar si masë sigurimi për personin nën hetim F. Ll. atë të “arrest shtëpie”.

Ankuesi, në denoncim, citon dhe disa rrethana se personi nën hetim F. Ll. ka qenë i proceduar më parë për kalim të paligjshëm të kufirit. Ka qenë i dënuar më parë në vitin 2009 nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, si anëtar i një grupi të strukturuar kriminal etj., që, sipas tij, përbëjnë rrethana rënduese.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Komisioni i kaloi barrën e provës duke kërkuar nga subjekti të japë shpjegime në lidhje qëndrimin e mbajtur ndryshe nga qëndrimi i prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se ndryshimi i masës së sigurisë është bërë në bazë të një analize të hollësishme juridike dhe ka arritur konkluzionin se nuk ndodhemi përpara kushteve të caktimit të masës së sigurimit “arrest me burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti ka argumentuar se në lidhje me qëndrimin e tij është mbështetur në faktin se pas marrjes së vendimit kanë dalë prova të reja, të cilat subjekti pretendon se i ka argumentuar në mënyrë të hollësishme në kërkesën për ndryshimin e masës së sigurimit.

Si provë të re, subjekti ka konsideruar një deklaratë noteriale të datës 13.3.2019, me nr. ***, e lëshuar nga shtetasi E. Ç., i cili ka dhënë në mënyrë të hollësishme argumente, që roli i personit nën hetim F. Ll. në kryerjen e veprës penale “vjedhje” është i zbehur plotësisht. Subjekti argumenton gjithashtu, se masa e sigurimit më e përshtatshme, nisur nga rrethanat e kësaj çështjeje është “arrest në shtëpi”, të parashikuar në nenin 237, të Kodit të Procedurës Penale, kjo nga fakti që babai i personit nën hetim F. Ll. ka një sëmundje të rëndë, është invalid dhe i verbër, personi F. Ll. është i martuar dhe rri vetëm me të dy prindërit që janë të moshuar dhe është i padënuar më parë dhe nuk ka rrezik të largohet apo të prishë provat. Në caktimin e kësaj mase janë vlerësuar drejt kriteret e përgjithshme, neni 229/1/2 i Kodit të Procedurës Penale ashtu dhe kriteret e veçanta, neni 230/1 i Kodit të Procedurës Penale. Subjekti shprehet se qëndrimi i mbajtur është në përputhje të plotë me kriteret ligjore.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se pasi dëgjoi shpjegimet e subjektit, provat e depozituara prej tij, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse.

Subjekti, në analizën e tij, ka deklaruar se kërkesa për ndryshimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” me “arrest në shtëpi” është e bazuar në nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni vëren se deklarata noteriale, e cila ka shërbyer si dokument bazë, pra, konsideruar nga subjekti “si provë e re” pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk përbën provë të plotë, e cila mund të ndikojë në ndryshimin e masës së sigurimit, kjo për arsye se është një deklaratë noteriale, e cila është bërë pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Shkallës së Parë⁹². Në deklaratën noteriale ka dhënë disa shpjegime personi E. Ç., i cili të njëjtat shpjegime i ka dhënë dhe gjatë procesit në shkallë të parë dhe këtë deklaratë mund ta bënte gjatë këtij procesi “për t’i lehtësuar pozitën” personit në hetim F. Ll. dhe nuk kishte përse ta bënte pas dhënies së vendimit.

Subjekti i rivlerësimit ka përmendur si rrethana lehtësuese edhe disa fakte si: “...babai i personit nën hetim F. Ll. ka një sëmundje të rëndë, është invalid, është i verbër, personi F.Ll. është i martuar dhe rri vetëm me të dy prindërit që janë të moshuar dhe është i padënuar më parë dhe nuk ka rrezik të largohet apo të prishë provat, fakte këto të cilat nga gjykimi rezultojnë të përmendura nga mbrojtësi i personit nën hetim F. Ll., për të cilat nuk ka paraqitur dokumente provuese për sa ka pretenduar. Subjekti i rivlerësimit duhet të bënte një vlerësim të këtyre fakteve të pretenduara, të mbështetura në prova dhe jo duke u mjaftuar vetëm mbi bazë deklarimesh.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Edmond Hyka, nuk ka respektuar si duhet dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (konkretisht nenet 228-230), duke mos bërë një vlerësim dhe një analizë të thellë dhe të drejtë të kriterëve ligjore, gjë që ka çuar në një qëndrim jo të drejtë të subjektit të rivlerësimit në kërkesën e tij për ndryshimin e masës së sigurimit personal, nga masa “arrest me burg” në “arrest shtëpie”.

Në lidhje me papajtueshmërinë apo situatën e konfliktit të interesit me funksionin e prokurorit.

Subjekti i rivlerësimit, në bazë të kontratës së shitjes së datës 22.5.2005, ka përfitur nga shitësi I.Nj.Ç. një apartament me sip. 121 m², për çmimin 2,000,000 lekë me adresë: Rr. “****”, Durrës. Sipas deklarimeve të subjektit, konfirmohet se blerja e këtij apartamenti është bërë në vitin 2002 dhe më pas është finalizuar me kontratë shitjeje në vitin 2005.

Subjekti ka konfirmuar marrëdhënien e vazhdueshme me shtetasin I.Ç. që nga viti 2002 dhe në deri në vitin 2005.

Duket se subjekti i rivlerësimit është trajtuar në mënyrë preferenciale nga shitësi I.Ç. në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit, pasi rezulton se apartamenti i është shitur subjektit 3-fish më lirë se çmimi referues ligjor, parashikuar në udhëzimin e EKB-së⁹³. Komisioni ka hetuar dhe çështjen e konfliktit të interesit apo dhe papajtueshmërisë me funksionin e prokurorit dhe, për këtë arsye, ka

⁹²Deklarata noteriale mban datën 13.9.2019, ndërsa vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë mban datën 10.9.2019.

⁹³Duke iu referuar dhe udhëzimit nr. ***, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja dhe të koeficientit ‘K’ për vitin 2005”, EKB-ja ka përcaktuar se nga të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin Durrës, çmimi i apartamenteve përllogaritet me vlerën 54,383 lek/m² dhe për apartamentin konkret është 121 m² x 54,383 lek/m² = 6,580,343 lekë.

kërkuar nga Prokuroria e Apelit Tiranë në lidhje me çështje penale, që mund të ketë pasur shtetasi I.Ç. pranë kësaj prokurorie.

Prokuroria e Apelit Tiranë, në përgjigje të saj,⁹⁴ ka konfirmuar se në Prokurorinë e Apelit Tiranë janë trajtuar çështje penale ku kanë pasur cilësinë e palës në gjykim shtetasit I.Nj.Ç. kërkues, me objekt gjykimi: kundërshtim vendim pushimi të procedimit penal nr. ***, të vitit 2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Edmond Hyka, datë 20.3.2018, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimin e Komisionit

Komisioni, me kalimin e barrës së provës, kërkoi nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me situatën e konfliktit të interesit dhe mosheqjen dorë nga funksioni i prokurorit të Gjykatës së Apelit për këtë çështje.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“...ju sqaroj se kundërshtimet e vendimeve të pushimit në bazë të nenit 329, të Kodit të Procedurës Penale zhvillohen në dhomë të këshillimit nga kolegji gjyqësor, pa pjesëmarrjen e palëve, fakt ky i pasqyruar edhe në faqen nr.2, të vendimit nr. ***, datë 20.3.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

*Në këto lloj gjykime, ne si prokurorë nuk marrim pjesë, ndonëse çështjet e kësaj natyre hidhen në short, por nga unë këto lloj procedimesh, përderisa nuk marr pjesë nuk jam i interesuar së cilat janë palët e interesuara. Unë nuk e konsideroj konflikt interesi faktin se sipas shortit të hedhur në Prokurorinë e Apelit, për këtë procedim kam qenë unë, si prokuror, kur vetë ligji ma ndalon të marr pjesë dhe aq më tepër kur Gjykata e Apelit Tiranë ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit I.Ç., duke vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. *** akti, datë 2.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (bashkëlidhur dhe kopjen e vendimit)”.*

Gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore, ndër të tjera, ka sqaruar se subjekti nuk ndodhet në situatë konflikti interesi, sepse nuk ka marrë pjesë në gjykim, nuk e lejon ligji të marrë pjesë, nuk është drejtues, etj.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor

Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse.

Ashtu siç është pranuar nga vetë subjekti në shpjegimet e tij, çështjet penale në Prokurorinë e Apelit Tiranë hidhen në short dhe i caktohen prokurorit, që do të përfaqësojë çështjen në Gjykatën e Apelit.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 26, parashikon “heqjen dorë të prokurorit”, i cili në pikën 1, përcakton se prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17.

Neni 17, i Kodit të Procedurës Penale “heqja dorë e gjyqtarit”, e cila është e njëjtë dhe me atë të prokurorit në germën “ë” të tij, e lidh dorëheqjen me rastin e “ekzistencës së shkaqeve të tjera të rëndësishme të njëanshmërisë”.

Në rastin konkret ekzistojnë rrethanat ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në një situatë, marrëdhënie interesi, me palët pjesë të atij procesi, çështje e cila i ishte caktuar me short subjektit të rivlerësimit.

⁹⁴Shkresë me nr. *** prot., datë 4.12.2019, nga Prokuroria e Apelit Tiranë.

Subjekti Edmond Hyka ka konfirmuar marrëdhënien me shtetasin I.Ç. nga viti 2002 deri në vitin 2005, duke finalizuar kështu dhe veprimin e shitblerjes së apartamentit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi objektive për të ushtruar funksionet e tij si prokuror dhe duhej të kishte deklaruar heqjen dorë nga kjo çështje, ku palë ishte shtetasi I.Ç.

Pavarësisht pretendimit që ngre subjekti, që roli i tij ka qenë pothuaj i zbehur dhe gjykata ka vendosur në disfavor të tij, praktika juridike nuk e lidh këtë fakt me ushtrimin e ndikimit ose jo, apo me qëndrimin pro apo kundër të subjektit ndaj palës me të cilën ka pasur një marrëdhënie, por rezulton se vetëm fakti i qenies pjesë e një procesi me një palë ku ka ekzistuar një marrëdhënie, në rastin konkret interesi, kjo do të ishte e mjaftueshme që subjekti në zbatim të ligjit, të jepte dorëheqjen.

Në bazë të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti Edmond Hyka, që në momentin e caktimit me short të dosjes me palë shtetasin I.Ç., duhej të kishte kërkuar heqjen dorë nga kjo çështje, kërkesë kjo drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, edhe pa shprehur qëndrimin e tij në këtë çështje.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e tij procedurale për sa i përket heqjes dorë apo deklarimit të papajtueshmërisë së ushtrimit të detyrës së tij, të prokurorit në çështjen në fjalë, si pjesë e rëndësishme e etikës së magjistratit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional janë konstatuar mangësi dhe problematika në aspektin procedural nga subjekti i rivlerësimit në nivel minimal, si dhe një situatë konflikti interesi, por trupi gjykues vlerëson se nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit “E” të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe për rrjedhojë, trupi gjykues, marrë në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në pikën 2, të nenit 4, germën “c”, pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve, nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 20.12.2019

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Xhensila PINE

Kryesues

Olsi KOMICI
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtar

Olsida Goxhaj
Sekretare gjyqësore